




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 631-22-4854-5-2-1/C183

KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik **ELING GRUP SH.P.K.; MONTEN SH.P.K., MUHARREM FEJZA OBJ.1 LOK.1-1, PRISHTINE**, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Elektrifikimi i bjeshkës së Belegut me numër identifikues: 631-22-4854-5-2-1 me nr. Të bren. 631 22 018 521.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Elektrifikimi i bjeshkës së Belegut**

No.	Lot
1	Elektrifikimi i bjeshkës së Belegut

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 336 891,64 €; [Treqindetridhjetegjashtëmijëetetqindenentdhjetenji e gjashtdhjetekater] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Në bazë të kërkesës së Ekzekutivit të Komunës, të dt.21.02.2018, nr.01-5248, për hapjen e rrugës së re që lidhë rrugën "Himë Mushkolaj-Haxhi Mushkolaj", sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, duke u bazuar në nenin 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 21 dhe 25 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.28.02.2018, bie këtë:

V E N D I M

PËR HAPJEN E RRUGËS SË RE QË LIDHË RRUGËN "HIMË MUSHKOLAJ-HAXHI MUSHKOLAJ" NË ZONËN URBANE

I.

Merret Vendimi Për hapjen e rrugës së re që lidhë rrugën "Himë Mushkolaj-Haxhi Mushkolaj" në Zonë urbane në qytetin e Deçanit, me gjatësi L=367,13 m dhe gjerësi Gj=5,0 m, Zona Kadastrale Deçan, të evidentuara si pronë private.

II.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapsinorë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit duhet të kompletojnë lëndën sipas procedurave të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe t'i drejtohen Komisionit Ndërmësor për vlerësim dhe shpronësim të pronave.

III.

Për procedurat e Implementimit të këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapsinor dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit, ndërsa mbikëqyrjen e implementimit do ta bënë Kryetari i komunës.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapsinorë, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.II-5

Deçan, dt.28.02.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

HYTESHMERKAZHA-IMQINIP
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DECANI - DEÇAN MUNICIPALITY

Me: K. Deçani AS Nr. Proc: 6839
Dn: 01 Dn. Prot: 08.3.18
M. i tregut: 01 Dn. Prot: 08.3.18
No. Prot: 01 Dn. Prot: 08.3.18
DEÇAN, DEÇANE

Faqe 1 nga 1

Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj



KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

DECANI

Mbledhja e Kuvendit të Komunës

(Legjislatura e VII , mbledhja e I) me dt.27.02.2025

DEÇAN

e Enjte, 27 Shkurt 2025

Hajdar Sutaj

Akuzohem që ne po ju themi me ndërpre, përgaditu qysh është më së miri.

Shumë të nderuar kolegë e kolege, anëtarë të kuvendit komunal të Deçanit, të nderuar drejtorë e drejtoresha të nderuar përfaqësues të OSBE-së gjithë ju të pranishëm, kolegët i kisha lutë për vëmendje për qetësi. E hapi takimin e 1-rë të vitit 2025 të kuvendit komunal fillimisht konstatoi që nga 27 anëtar 24 janë prezent, 3 kolegë mungojnë që nënkupton që kemi kurum të mjaftueshëm me vazhdu me punimet e seancës së kuvendit ashtu siç e keni marrë edhe materialin për rend të punës kemi propozuar këto pika, shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit nga mbledhja e kaluar, 2 shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës së kuvendit për vitin 2025, 3 shqyrtimi dhe miratimi i planit të Kksb-s për vitin 2025, 4 shqyrtimi i raportit të punës njëvjeçare të kryetarit të komunës, 5 shqyrtimi i raportit të punës njëvjeçare të komitetit të komuniteteve, 6 shqyrtimi i raportit analitik financiar për vitin 2024, 7 shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të komisionit komunal për emërtimin e rrugëve, lista me emra rezervë të rrugëve të komunës Deçanit, 8 të ndryshme.

Para se me kalu fjalën te ju më lejoni që te pika të ndryshme do ta kemi një plotësim të vendimit për planin zhvillimor ka të bëjë me ndryshimin tek teksti vetëm të një ligji i cili, domethonë vetëm ta lexoj lidhur me nenin 10 paragrafi 2, pika 2.2 nënpika 2.2.1 dhe largohet pika 2.1 domethënë i shtohet është harruar vetëm një numër kur është bërë vendimi, po ashtu ishte kërkesë e kryetarit Bashkim Ramosaj që shqyrtimi i raportit të punës një vjeçarë i kryetarit të komunës të kaloj tek pika e dyt për shkak se ka pasur një operim të sinusëve dhe nuk është mirë me shëndet. E po ashtu edhe drejtoresha për buxhet e financa e kishte kërkesë që pika shqyrtimi i raportit analitik financiar për vitin 2024 meqenëse ka për të shkuar në një takim në Prishtinë të kaloj si pika e 3-të, do të thotë vetëm 1 kërkesë në renditje që shqyrtimi i raportit të punës 1 vjeçar të kryetarit komunës të kaloj pika e 2-të dhe pika 6-të që është aktualisht shqyrtimi i raportit analitik financiar për vitin 2024 të kaloj pika e 3-të e hapi diskutimin për rend dite, nëse ka dikush diçka, Faruk a kishte diçka për të thënë në rregull, Sylë Balaj.

Sylë Balaj

Atëher përshëndetje për të gjithë, para se të hapim edhe seancën, kisha pasur dëshir ta nderojm me një minutë aktivistin ()

Hajdar Sutaj

Po i nderuar koleg shprehi ngushëllimet më të sinqerta familjes Tishukaj kolegëve tanë të qendres së Vetvendosjes në Deqan, qytetarëve bashkëqytetarë të fshatit Isniq gjithë komunës së Deqanit, miqëve kolegëve bashkëpunëtorëve, shpirti i tij pushoft në paqe dhe po ashtu ju ftoj për një minut nderim, i përjetshëm kujtimi për të. Në lidhje me rendin e ditës a patët diçka Vatan urdhëro, Vatan Istrefaj.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesues, përshëndetje për të gjithë vetëm desha të deklarohe se tek pikat e ndryshme kam 2 pyetje për kryetarin e komunës njëra ka të bëjë me drejtorinë për zhvillim ekonomik faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë atëher me propozimin si e dhashë dhe me ndryshimin e renditjes e qesë në votim këtë rend dite kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që kuvendi komunal mënyrë unanime, ka miratuar rendin e punës dhe vazhdojmë sipas radhës, 1 shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit nga mbledhja e kaluar, e hapi për diskutim nuk ka, kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që kuvendi komunal e ka miratuar transkriptin e mbledhjes së fundit.

Jemi te pika e 2-të por meqenëse kryetari është në intervistë në telefon po e kalojmë tek pika e 3-të deri sa te kthehet, te kjo shqyrtimi i raportit analitik financiar për vitin 2024 drejtoresha a ke diçka më thanë, drejtoresha

Dafina Cacaj e ka fjalën

Dafina Cacaj

Faleminderit kryesus përshëndetje për të gjithë, me material keni të bashkangjitur raportin një vjeçar financiar të komunës së Deqanit, komuna e Deqanit ka shpenzuar 98% të buxhetit kemi shpenzim të buxhetit më shumë se sa që e kemi pas planifikim për arsye të dy vendimeve qeverisje që janë marr në fund të vitit për pagat në arsimin fillor dhe të zjarëfiksat për shkak se kemi qenë në minus dhe kanë marr vendim që me i shtu. Po ashtu të të hyrat kemi rritje, kemi tejkalim të të hyrave vetanake nga planifikimi ka qenë, të planifikuara 847000 e tash janë 65, kemi arrit edhe 23.000 më shumë pa i llogarit të hyrat nga gjykata dhe policia për shkak se janë të hyra indirekte që nuk hyn në planifikim. Shpenzimet e komunës janë përafërsisht sikur në muajin nëntor tetori që kanë qenë 9 muji i fundit nuk ka shumë dallim prej atij të mëhershmit janë edhe 3 muji i fundit i bashkangjitur këtu nëse keni pyetje ose diçka të paqartë, unë mundem me u përgjigj ose kryetari faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë atëhere sipas një tradite që e kemi fillimisht emrat grupeve diskutojmë nëse është dikush në emër të grupit të Aak-s që dëshiron me diskutu zotri Arian Dobraj e ka fjalën.

Arjan Dobraj

Faleminderit kryesues Sutaj i nderuar kryetar të nderuar kolegë asambleist, drejtorët të drejtorive, faleminderit për fjalën edhe një herë, faktikisht në parim normal se pajtohem me raportin e kryetarit të komunës, më fal për raportin analitik financiar, vetëm deshta nga kolegët nëse ka dikush me shtu diçka në veqanit ja jap fjalën edhe këtyre faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë nga grupi i Ldk-s Hyri Dobrunaj e ka fjalën.

Hyri Dobrunaj

Raportin financiar e kemi diskutuar edhe në KpF kur e kemi mbajt normal që po bëmë unë edhe Ariani gjithmonë në kundërshtim shumë të madh ndërmjet veti ky shumë po pajtohen e unë asnjëherë e kështu që kërkoj falje por kemi tërheq vërejtjen si grup parlamentar tek mjetet e tërhequra nga përmbaruesit që po e tërheqin vit pas viti vërejtjen edhe vitin e kaluar e kemi tërheq vërejtjen të kemi thënë që keni me ardh në fund që nuk keni me mujt pagat mi pagu kjo ka ndodhur është dashur me ju ndihmu për me i pagu 4.380.000 me i marrë përmbarusi mbrenda një viti kalenderik me të vërtetë është shumë ne nuk i kemi as investimet kapitale aq kështu që është tragjike edhe unë si ky nuk dua me zgjat shumë se du edhe kolegët secili marrë pjesë në diskutim, mirëpo disa gjana që janë të pakalueshme në këtë raport financiare, atëherë kur e shohim këtë, ky raporti i kryetarit që kemi me diskutu nuk ka hiq rëndësi të gjitha ato qfar shkruajn në letër duhet me u lidhë me këtë raport e ky nuk ka mundur as një punë me kry se ky nuk ka pasur asnjë mjet financiar në komunë do të thotë 4.388.000 që janë marrë nga përmbaruesi nuk pajtohem me këtë duheni me gjetë një zgjidhje tjetër qysh me i bo pagesat se në këtë mënyrë është e patolerueshme, kemi me falimentu si komunë dhe nëse jo këtë vitë, vitin e ardhshëm gjithsesi, derivatet të shpenzume prap avazi i vjetër 100.157 euro 100.000 është shumë për një komunë kaqë të vogël dreka zyrtare kam dashur të ju komplimentoj këtë vitë sepse e kam parë shifren 39.000 edhe kam thënë shumë mirë se paskemi mbërri me një pik me i zbrit ato dhe është mirë mirëpo e kam kuptur më vonë që ju këto drekat dhe darkat zyrtare i keni futur te shpenzimet për udhimet zyrtare mbrenda jasht vendit do të thotë kur i mbledhim edhe këto krejt atëherë na del 125.972 euro plus këto 39.000 që janë shumë është tejkalu edhe ma shumë se të gjitha vitet tjera do të thotë edhe kjo është skandaloze për një komunë të vogël qfare jemi ne. Sapo e tha drejtoresha e kemi arrit me i rrit të hyrat vetanake dikund për 20 e diçka mijë nëse të kam dëgjuar mirë nuk jam e sigurt mirpo kur e shohim që veq telefoni mobile kemi paguar 52.000 brenda një viti kalendrik atëhere ajo rritja është e pakuptim 20.000, nëse i shohim krejt bashkë komuna e Deqanit mobil fiks edhe mobil ka shpenzuar prej një vitë kalendrik 56.880 euro që është shumë, është shumë e madhe e patolerueshme vazhdon avazi me shërbime të veçanta intelektuale edhe për këtë vit me 267.000 që është marr prej mallrave dhe shërbime e që është shumë, do të

thotë nëse na i marrin mallra e shërbime sikur përmbaruesi që ka marrë të gjitha nuk ka marrë vetëm te kapitalet por ka marr edhe të tjerat do të thotë qytetarëve ju mungojn shërbimet Kjo do të thotë se diçka nuk është në rregull diçka nuk është mirë kështu që për mua ky raport financiar është skandaloz më skandaloz prej të gjithëve deri tash deri sot.

Hajdar Sutaj

E nga grupi vetëvendosjes Teuta Neziraj e ka fjalën.

Teuta Neziraj

Atëherë përshëndetje për të gjithë i nderuar kryesues të nderuar asambleist i nderuar kryetar edhe këtë vit kalendarik 2024 po shohim një raport të shpenzimeve i cili për neve nuk është në rregull duke i parë të gjitha këto shpenzime, sidomos tek vendimet gjyqësore epo ashtu siç e tha edhe bashkëfolsja më herët kemi pa shpenzime vit pas viti sidomos te derivatet mirëpo këtë vit jemi duke pa shpenzime marramendëse tek telefonja mobile. Duam ta bëjmë konkretisht edhe një pyetje te shpenzimet, shpenzimet dhe akomodimi jashtë vendit me na u përgjigj ku janë këto shpenzime dhe qfarë janë këto takime zyrtare jashtë vendit se po shohim shumat janë goxha të larta faleminderit.

Hajdar Sutaj

Zotri Mon Selmanaj a dëshironi ju? në rregull Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues përshëndetje kryetar përshëndetje koleg të nderuar. Çdo raport cilido qoftë ai që vjen në kuvend në këtë rast ne e kemi raportin një vjeçar financiar analitik ka për qëllim të njoftojë organet ekzekutive, kuvendin komunal dhe qytetarët për realizimin e buxhetit të komunës duke përfshirë buxhetin e secilës drejtori veç e veç. Ky raport analitik financiar për vitin 2024 i ardhur në këtë formë e që na paraqitet planifikimi i buxhetit për vitin 2024 dhe shpenzimin e këtij buxheti sipas kategorive ekonomike, mendoj se nuk është transparent sa duhet për kuvendin dhe publikun, e arsyetoi me faktin që forma e ardhjes së këtij raporti lenë shumë shprazëti që ne si të deleguar të qytetarëve këtu ti nxjerrim të gjitha shpenzimet për të cilat ne jemi të interesuar dhe qytetari është i interesuar. Arsyeja është se përmes kodeve ekonomike nën programeve, shumat e shpenzuara sipas këtyre kodeve nuk kemi asnjë të dhënë tjetër që dëshmon shpenzimin e parasë publike nuk janë transparente datat e faturimit, pagesave të ndara sipas muajve etj. Këtu hasim një kod ekonomik, për shembull furnizim me ushqim dhe pije në kllapa jo dreka zyrtare në shumën prej 39.845 euro unë e kisha bërë pyetje çka nënkupton kjo? jo dreka zyrtare kur ka ushqim dhe pije ose në cilin kod ekonomik fshihen drekat zyrtare, nuk besoj që për 1 vit nuk ka asnjë shpenzim tjetër sepse praktikat e deritanishme nuk e dëshmojnë këtë. Në nën programin derivatet për automjete, gjeneratorë dhe makineri janë të bashkdyzuara të gjitha shpenzimet në një vend dhe na është pamundësuar të dimë secili shpenzim veç e veç me këto nënprograme, për 1 vit kalendarik pagesat sipas vendimeve gjyqësore përmbarimore kapin shifrën 4.388.913 çka dëshmon se ne kemi humbur me dhjetëra mijëra euro nga buxheti nga 1 mos planifikim i mirë i shpenzimeve të paras publike, për shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, transportit, akomodimit dhe shpenzimet tjera janë shpenzuar për një vitë hiç më pak se 47.369 euro, shërbimet e veçanta, konsulent dhe kontraktuar individual për kompensimet e përfaqësimit brenda vendit janë shpenzuar 78.600 euro. Subvencionet për entitetet publike dhe jopublike janë 178.984 euro, telefonja fikse dhe mobile 56.879 euro, të nderuar kolegë për të gjitha këto e shumë të tjerë në këtë raport lenë vend për të dëshiruar lenë vend që ekzekutivi të reflektoi këtë vit me shpenzimin e mirëfillt të parasë publike ju faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Mon dikush tjetër është lajmëru Albesa Cacaj, pastaj Blinera pastaj Vatoni, Albesa Cacaj e ka fjalën.

Albesa Cacaj

Të nderuar të pranishëm një raport i komunës së Deqanit për vitin fiskal 2024, të cilin e shqyrtojmë sot. Raporti financiar unë mendoj kryetar edhe problemin e kam me mënyrën e përpilimit dhe përgatitjes si na vjen raporti vit pas viti, sepse të gjithë jemi të vetëdijshëm se sa i përket shpenzimeve nuk ka ndonjë ndryshim e njëjta situatë është përsëritur. Atëherë raporti financiar do të duhej të paraqiste 1 pasqyrë të hollësishme të të ardhurave, shpenzimeve dhe gjendjes financiare të komunës gjatë 1 periudhe të caktuar kohore zakonisht një viti fiskal. Ky raport do të duhej të ishte 1 dokument kyç për qytetarët, organet e qeverisjes dhe institucionet mbikëqyrëse për të siguruar që fondet publike të përdorur në mënyrë transparente dhe efikase ky raport paraqet mungesë të detajuar të informatave dhe rrjedhimisht mungesën e transparencës financiare, e cila do të duhej të ishte parimi thelbësor i qeverisjes së mirë në komunën tonë. Pse është e rëndësishme transparenca dhe informatat më të detajuara në raportin financiar llogaridhënia publike, qytetarët kanë të drejtë të e dinë se si përdoren fondet publike dhe nese ato shpenzohen në mënyrë të drejtë dhe efikase një raport i detajuar zvogëlon mundësinë e keqmenaxhimit ose keqpërdorimit të fondeve besimi i qytetarëve sa më transparente të jenë institucionet, qytetarët do të ndiheshin të përfaqësuar drejtë, transparenca rrit mundësitë për mbështetje nga organet e ndërkombëtare dhe investitore, një raport financiar i komunës duhet të përmbajë emërtimet dhe përshkrimet e detajuara të shpenzimeve, në mënyrë që qytetarët të jenë të vetëdijshme ku shkojnë taksat e tyre. Për shembull, në vend të 1 përmbledhje të përgjithshme tek emërtimet, rrethojat urat, rrugët lokale, trotualet, rrjetet e kanalizimit raporti duhet të përmbajë detajet e qarta, si për shembull kur vjen fjala te rrethoja, po supozojmë rrethoja në shkollën Lidhja e Prizrenit me gjatësi kaq me mjetet e shpenzuara kaq ose rrugë lokale supozojmë rruga dëshmorët e kombit, gjatësia kaq dhe projekti i realizuar me vlerën kaq, pse është e rëndësishme që emërtime të jenë të detajuara si për këshilltarët ashtu edhe për qytetarët, sepse 1 raport i tillë tregon qartë se ku janë shpenzuar paratë dhe lejon krahasimin me punën e kryer në terren një raport i tillë ka shumë hapësirë për manipulime dhe keq menaxhime të fondeve, edhe une si të nderuarit parafolës që shtjelluam.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Blinera tash rregullorja se me ja fillu ashtu Blinera Lokaj e ka fjalën edhe sa e ki në rregull vazhdojani edhe një minutë.

Albesa Cacaj

113.000 euro shërbime të veçanta, 100.507 mijë euro shërbime tjera kontraktuese, akomodime, shpenzime jashtë vendit, transport jashtë vendit rreth vlerës 45.000 euro telefoni mobile që e kemi theksuar vazhdimisht edhe në 3 mujour dhe gjashtëmujour, nënmujour rreth 56.000 euro. Pajisje të tjera që kurrë nuk e dimë çka sakson çka domethonë, cilat janë pajisje tjera rreth 63.000 euro derivate rreth 80.000 euro mirëmbajtje rutinore, pastaj furnizim zyre dhe këtu shpenzime enorme kompjuter rreth 40.000 euro pajisje tjera për ku çfarë për çka përdoren mirëmbajtje teknologjisë dhe çka nuk e kom pasur të qart të nderuar transferet sociale për individin, nëse mundet kryetari ose drejtoresha për të na qartësuar faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit po ashtu, Blinera Lokaj e ka fjalën.

Blinera Lokaj

Faleminderit kryesues përshëndetje për të gjithë, 1 raport financiar si ky i pa detajuar përfshin 1 përmbledhje të përgjithshme të shpenzimeve, por nuk jep detaje të hollësishme në lidhje me pagesat dhe transaksionet specifike. Duke iu referuar të dhënave në këtë raport, shohim se komuna e deqanit vazhdon me keqpërdorim e parasë publike, duke kryer shpenzime që nuk lidhen fare me kërkesat dhe prioritetet e qytetarëve. Paratë e shpenzuara për transport akomodim, meditare, avancë si dhe shpenzimet e tjera për udhëtime zyrtare janë plot 46.000 euro. Cili ka qenë qëllimi konkret i këtyre udhëtimeve zyrtare të realizuara nga ekzekutivi komunal? A ka pas ndonjë projekt konkret apo përfitim për qytetarët dhe komunën tonë, si dhe e konsiderojmë çështje udhës që pas secilit udhëtim zyrtar të krijohet 1 sipas secilit udhëtim jashtë vendit, të krijohet 1 raport zyrtar mbi i rezultatet e arritura, pastaj kemi telefoni mobile dhe fikse 50.000 euro dreka zyrtare të paguara me kodin kompensimi i përfaqësimit brenda vendit, të cilat së bashku me furnizim me ushqim dhe pije në total janë 117.970 euro. Shërbime këshillëdhënëse, shërbimet e veçanta dhe shërbime kontraktuese 345.000 euro dhe duke u bazuar në këtë raport të mangët, ne nuk mund ta dimë a janë kryer këto pagesa në vitin 2024 apo janë

pagesat e viteve paraprake. Shqetësuese në këtë raport mbeten kodet buxhetore të paqarta të paspecifikuara, si dhe përshkrimet me disa emërtime të pakuptimta, pastaj shihet që janë kryer pagesa që nuk lidhen fare me drejtorinë përkatëse, pra me 1 fjalë është 1 raport i mangët i padetajuar, i pa strukturuar kështu që kishte qenë mirë që prej marsit të na vije forma e mëhershme e raportit.

Hajdar Sutaj

Vatan Istrefaj.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesues përshëndetje edhe një për të gjithë.

Po filloj fjalimin për këtë raport, nuk pajtohem fillimisht me kolegen Albesa që thashë është raporti i formës së njëjtë nga herët e kaluara nuk është i njëjtë, pasi që duke filluar nga përmbarimet kujtohet qysh në fillim kur e kemi marrë mandatin për këtë legjislaturë në fillim të mandatit, komuna e Deçanit ka paguar rreth 2 milionë euro përmbarime tani pas 4 viteve po e përmbysim me rreth dikund 4.388.000 euro përmbarime e po ashtu të kontratat në vepër apo siq janë shërbimet intelektuale të cekura në kodin buxhetor duhet të di sakt sa kontrata në vepër i ka komuna e Deçanit, pasi që kjo po rëndon shumë buxhetin e komunës sonë, për shkak se deri më tani kemi paguar rreth 267.000 euro vetëm kontratën në veper, po ashtu për dallim nga hera e kaluar ky raport, avancet, pra paraja kesh është rritur në shfrytëzim për këtë vit, përmbarimet gjithashtu dreka zyrtare, edhe pse keni munduar të manipuloni pak me kodin buxhetor, ndoshta kete e keni bërë edhe me institucionet në qeveri atje që ka ndërruar emrin e kodit, duke filluar nga kompensimi përfaqësimit brenda vendit, tash në fund ka ardhur edhe dreka zyrtare në fillim të mandati i kemi parë dikund 100.000 euro dreka zyrtare tash i kemi 130.000 apo më shumë e kështu me radhë, por qfar më prek më shumë është tek drejtoria e shëndetësisë përmbaruesi ka marrë afro 200.000 euro brenda këtij viti, vetëm me një pagesë ka marrë 150.000 nëse kishin pasur një raport financiar të mirëfilltë, për çfarë do të kishin qenë të destinuar këto para në drejtorinë e shëndetësisë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Sylë, Sylë Balaj e ka kërkuar fjalën.

Sylë Balaj

Atëher përshëndetje për të gjithë, pasi që shumicën e ceken edhe kolegët unë kam vetëm një pyetje për kryetarin, te kodi buxhetor kompensimeve, përfaqësimin brenda vendit a janë vetëm dreka zyrtare në këtë kod apo ka diçka tjetër se shpenzimet janë shumë të larta faleminderit.

Hajdar Sutaj

Po Orges Tafilaj.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesisht përshëndetje për të gjith kolegët realisht unë desha të ndërlidhem vetëm te përmbarimet fillimisht për shkak që përmbarimet jo vetëm që po na humbin një pjesë të buxhetit e cila mund të shfrytëzohej për investime kapitale por rrjedhimisht edhe po na pamundëson që ti kryjm pagesa në afatet e tyre ligjore dhe kjo po përcillet si një zinxhir që ndikon pastaj edhe të raporti i auditorit dhe njëkohësisht arsyeja pse e mora fjalën është që të ju sugjeroj që të përfillen rekomandimet e auditorit meqenëse të kemi një raport më të mirë për ta faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges, Miftar Ahmetxhekaj.

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë kryesues, për fenomenin e keq veq u fol unë kryetar e kam vetëm një pyetje vlere e pagesa me vendime gjyqësore është 4 pikë diçka nëse është aplikuar 4 milione e diçka i ke paguar, nuk i ka kalkulova po u kalkuluan edhe besoj që nuk u kundërshtu si shifër. Nëse kësaj ia shtojmë 18 për qind që është normë e inkasimit kush e merr përgjegjësinë që këto janë para shtesë. Nëse ti e kishe kryer një detyrim mbi bazën e një afatit ligjor, automatikisht ishte ik prej kësaj përgjegjësie të cilën nëse nuk gaboje është dikund mbi 300.000 nese ti e kalkulon me 18% A ishte dashur të merr dikush përgjegjësi për këtë humbje të kësaj parasë që ti nuk i ke përgjigje brenda afatit ligjor, nëse jam në shifra gabim, nuk jam matematikan as ekonomist mirës me presion ju kisha lut të kalkulojë e 80-të përqindshin e 4 pikë diçka milion sa del shifra faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

A ka prej antarëve te kuvendit te lajmëruar tjerë për fjalë, përderisa nuk ka ka atëherë kryetari i komunës Bashkim Ramosaj e ka fjalën.

Bashkim Ramosaj

Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë juve për angazhimin në këtë pikë dhe publikimeve të tjera, dua ta sqaroj një fenomen që është negativ, jo për komunën e Deqanit po që është fenomen negativ për komplet komunat në Republikën e Kosovës që ka ardhur si pasojë e një vendimi të pa matun të pa ligjshëm në kuptimin e kësaj që ka ndodhë mas sepse veprimi ose prapa veprimi i këtij vendimi i ka godit komunat e Republikës së Kosovës dhe është një periudhë ma shumë se 4 vjeqare ku ne temë diskutimi edhe si asociacion i Kryetarëve të Komunave edhe në takimet kur ndajnë buxhet është me u zgjidh çështja e kontratës kolektive për cillen fajtor nuk jam as unë si kryetar i kësaj komune e as ndonjë kryetar i ndonjë komune tjetër në Republikën e Kosovës.

Mosgatishmëria e ministrisë së financave në këtë rast e ministrit që mos me u përballë me këtë fenomen na ka prurë në këtë situatë ku të gjitha komunat dikush më shumë dikush më pak është dasht me i mbështet me ju jep suportin për me funksionu deri në fund të vitit. Unë nuk jam një njeri që përfaqësoj një institucion mandatin e kryetarit që mundem me bë këtë zgjidhje dhe tash po folim pak më shtruar për këtë problematik, në rast se komuna e Deqanit ka të drejtë me projektu dhe me propozu ndarje nëpër kategori buxhetore cilat punë për investimet kapitolit duhet me përfundu e kemi thënë disa herë bashkë ose spaku unë e kam thënë në qdo takim kur kemi debatuar për ndarjen e buxhetit që kemi thënë dojm, i kemi nja 4 platforma mbi të cilat ne nisemi që një është çka mundemi me bë vetëm, një është qfar mundemi me bë në bashkpunim me qeverinë, një qfar mundemi me bë me mekanizma buxhetor të nivelit ndërkombëtar dhe një qfar mundemi me bë në bashkpunim me qytetarët dhe kjo skemë e prishet që me të drejtë u tha këtu prej Orgesit po më duket që e përmendni prishjen e skemës komplet buxhetore, sepse kur ty ti merr paret për kontratën kolektive dhe praktikisht e ki të lidhur një kontratë për një punë në infrastrukturë çfarëdo lloji qoftë ajo, kompania e cila e ka të siguruar buxhetin ajo ka me kryer punë dhe në momentin përmbaruesi ka marrë parat nga ky kod për atë është shumë e padurueshme dhe është dëm tepër i madh ekonomik, në rast se ai nuk mundet me i pagu punëtorë që ka kryer punë me ta dhe nuk mundet me i mbulu shpenzimet e veta dhe ai drejtohet te përmbaruesi dhe kjo skemë shkon duke u ngarkuar. Unë po mendohem me japë një përgjigje për krejt shqetësimet e juve po besoj për kontratën kolektive gjithë ne që kemi një provojë në këtë asamblë ose që jemi njerëz që mirremi aktivisht me këto tema ishte dashur me kuptu dhe ishte dashur që presioni mu bë në një adresim krejt tjetër, unë jamë gazuar që këto ditë ka marrë një debat më serioz, zgjidhja e kësaj problematike për shkak se janë 8 komuna që prej fillimit të shkurtit nuk mundën me funksionu e fatmirësisht nuk është Deqani që është si pasojë e kësaj edhe është njëfarë lloj kryeneçësie që duhet me u paditë filon ministri pse e ka nënshkruar në atë kohë kjo nuk është krejt serioze nuk është krejt e ndershme për shkak se ti, kur vjen në një post qoftë ministrit, qoftë kryetarit e ke për obligim me rregullu diçka që aj tjetri e ka bërë keq dhe jo me thënë hajde ta pushkatojmë tash këtë se unë po e rregulloj këtë farë debati. Po du me spjegju se u përmenden pak udhëtimet jashtë vendit ose temat tjera ndonjëherë ne kur flasim fjalë publike edhe duhet me i qëndru pas, sepse lëmë gjurmë me atë që e themi, kur lëmë gjurmë me atë që e themi e mundet koha me demantu në një situatë të caktuar ndoshta është mos prezenca ime me diskutu me gjithë juve pse po bëhet ky shpenzim ose pse unë duhet me shku dikun ose pse ekipi im duhet me shku dikun, mirëpo kur flasim për 47.000 euro unë besoj se kanë vlejtur vetëm dy takime të cilat kanë qenë të rëndësishme tepër të veqant për komunën e Deqanit një takim ka zgjatë 5 ditë dhe takimi tjetër ka zgjatuar dikund 8 ditë. Produkti i gjithë kësaj teme, unë jam i sigurt që do të shihet brenda këtij viti dhe atëherë ndoshta mundem me të flas më shpër me thanë që ky shpenzim ka shkuar për këtë po ashtu ne kemi pasur një temë shumë serioze me një shtet krejt tjetër, jo pse nuk guxoj ta them por i dashur me i prit rezultatet, çfarë do të ndodhë që ne të kemi njëfarë epilogu por unë jam tepër i lumtur që kam qenë pjesë e këtyre 3 takimeve sepse janë në funksion të publikut nuk janë në funksion timin as

individual as personal as familjar, po flasim për 2 takime që ndoshta më lejohet, takimi i parë ka ndodhur vetëm në Nju Jork takimi i 2-të ka ndodhur edhe në Nju Jork dhe në Uashington e që janë tema që e cenon në një farë mënyre perspektivën, jo unë flas vetëm për Deqanin, por e cenon një prespektivë të Deqanit për shkak të disa raporteve dhe mendimeve të një situatë që ne jemi dhe këto situata unë besoj e shpresoj shumë që kanë me u zgjidh dhe kanë me u zgjidh mbrenda këti viti në rast se nuk kerset najsen pak më serioze. Unë jam po ashtu idhtar që ti marr shumë seriozisht vërejtjet e juaja për raportet e shpenzimeve sepse është mirë me u mundu me kursy sa më shumë e kam bërë gjatë gjithë vitit këtë punë së paku personalisht, individualisht jam përkujdesur që me pasë shpenzime më të ulta mirpo që nganjëher nuk operohet, më lejon që... shumica prej jush i patët vërejtjet e njëjta, sepse janë në këtë raport dhe e kam një sugjerim në mirëbesim për zonjën Albesa të kisha thënë që me e thirrë drejtorin për buxhet dhe financa salla kemi të mjaftushme me ja mbajt një ligjerat qysh bëhet raporti dhe qfarë përmban raporti i shpenzimeve financiare? Kisha marrë pjesë edhe vet në këtë farë ligjerat tënde, shumë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Hyri Dobrunaj e ka fjalën.

Hyri Dobrunaj

E dëgjova me vëmendje kryetarin dhe në KpF e kam kërku prej drejtoris për financa me ditë shumë, sa është shuma për kontrata kolektive sakt, jemi të vetëdijshëm që ekziston kontrata kolektive edhe shujtat nuk na i paskan sjellur sod e kam besuar që ka me i sjellë, një kryetar komune duhet me qen menaxher i mirë patjetër në qoftëse nuk është krejt te kontratat kolektive këtë nuk mundesh me ne me diskutu kështu, ti mundesh më pas diskutimin e mirë mundesh edhe me thënë e ndëgjoj një ligjerat nga Albesa por ti ske nevoj për ato ligjerata, ti ske nevojë për ato ligjerata se ti dinë dhe këto ti mundesh me i bë ndryshe ti në shtëpi tënde nuk kishe lejuar përmbarsin me ardhë me ti marrë kështu edhe me të ndodh kjo ose në biznes tëndin privat kurr se kishe leju po këtu lejon a e din pse, edhe këta që po e thua tash edhe e 2-ta po mos të harroj udhëtimet jashtë vendit që janë shumë rëndësi, është e kuptueshme një kryetar komune duhet me pas edhe udhëtime jashtë vendit të gjithë jemi që e kuptojmë ata, mirëpo duhet me pas edhe 1 raport nëse ka çështje konfidenciale që ti nuk mundesh me i shkru në raport, ti mundshme me shkru që qëllimi i vizitës ka qenë madhor dhe na mundemi me kuptu, po ti je i detyruar të sjellësh një raport edhe përmbillet çështja , nuk mundem me besu unë këtë kërkoj falje por nuk mundem me besu se ka shumë shembuj që shkojnë, për shembull ka shku kuvendi në vizitë asnjë raport se ka sjellë asnjë të mirë për komunën, ato janë para të qytetarëve nuk janë tonat nuk kem të drejt me i shpenzu ashtu as ti si kryetar e as na e as kuvendi, as kërku tjetër, ju duheni, jeni te detyruar me pru raporte këtu ne kuvend edhe me reportu para ne edhe para qytetarëve kjo është krejt çka kemi dashur me thënë, nuk kemi kurgjo personale me kërkon këtu, por kur është në pyetje para e qytetarëve ti me pas biznesin tënd nuk e kishe shrytëzuar kështu, kemi të drejt me dysu kur i shofim duke qarkulluar mesazhet që ju tash i mbledhni aktivistat mas zgjedhjeve me shku ne Shqipëri pa pages, kush e paguan a e paguan ti nga xhepi juaj këtu në këto kode buxhetore janë të përfshira edhe ato për këtë po i kërkojm një raport të detajuar me ditë qfar paguhet ku paguhet.. jo jo ..mundemi edhe me kesh na mundemi me thënë edhe dëgjoj ligjeraten tënde por ato janë gjana të parëndësishme, janë të parëndësishme nuk është mirë me qen arrogant është mirë me bashkëpunu secili për me ndryshu gjendjen se kjo komuna për këtë moment është e juaja sepse je ti kryetar, nuk është e juaja je ti, por kjo është e fëmijëve tanë është e përbashkët nuk duhet të silleni kështu në shtëpinë tënde nuk do të sillësh kështu as ti as unë, qëllimi është i mirë kryetar për qata duhesh me ndëgju jo me arroganc.

Hajdar Sutaj

Kryetari i komunës e ka fjalën mundësisht Yll ja ndez mikrofonin pastaj drejtoresha është lajmëruar.

Bashkim Ramosaj

Po më vjen ndoshta zorë dhe po më vjen keq me u përgjegj shumë direkt do mundohem të jem më i balancuar në përgjigje, nuk ka ndonjë gjë konfidenciale, por ka udhëtime që unë nuk i kam bërë publike ose spaku në facebook timin nuk jam deklaruar ka mundur ndokush që ka qen me mu edhe me japë ndonjë informat. Jam nga pak ata njerëz që unë kam marrur ftesë me shku në një takim tash dhe më është dashur me refuzu për shkak të angazhimeve të tjera që kam pasur, të tregova edhe unë jam shumë serioz kur flas, jam shumë

serioz kur flas në këto tema sidomos në asamble për shkak se dikush nesër pasnesër ka me ardhë dhe ka me studiu komplet arkiven e këtij institucioni qoft për veprimin tim ose të ndonjë drejtori ose të ndonjë zyrtari dhe për vendimet ose veprimet që i kan bërë te pjesa e legjislativit në këtë far.. më preki kjo tema e shkuarjes në Shqipëri ku kemi shkuar si subjekt politikë, si shtab zgjedhor, si aktivista jam ndër tepër i lumtur që kam qen bashk me ta jam ndër po ashtu tepër i lumtur ndokujt që nuk i ka pëlqyer edhe ka mundur me bë ndonjë keqinterpretim, keqinformim po pak rëndësi ka kjo dhe e para unë kur shkojë dikund jam, besoj që jam personi i vetëm në Republikën e Kosovës që kam mandat zyrtar që nuk shpenzoj para të komunës po shpenzoj paratë e mia dhe për këtë poashtu jam njeri që kur shkoj në shtëpi, më zë gjumi shumë lehtë nuk e kam ndonjë kasavetë dhe për këtë poashtu kam thënë jam i lumtur që ka institucione e kam thënë disa herë e përsëriti disa herë, ka institucione që janë të ndërtuara në këtë shtet, mirë që janë ndërtuar që janë të adresuara dhe kanë kompetencë ekskluzive të veten me u marr me këto tema dhe për këtë flej qetë se nuk ka mundësi me pasë ndonjë penalizim në këtë far raporti. Unë e marr këtë pjesë, e marr shumë shumë seriozisht dhe nuk po besoj që përgjatë jetës time që kur kam lindur dhe jam rritur në këtë qytet, dikush mundet me thënë që unë ose familja ime kemi pasur ndonjë temë e cila mundesh me u prek në këtë far pike, nuk e bëjë kurr, nuk do ta bëjë kurr vetëm në rast se kaloj në ndonjë gjendje tjetër mentale dhe mundet me ndodh tani për tani jo. Për përmbarime edhe njëherë, për kontrat kolektive edhe njëherë po ju lus sinqerisht merreni më seriozisht këtë pjesë, analizoni qfar ka ndodh, analizoni mirë qfar ka ndodhë, analizoni kush është fajtori, janë fajtor 2 ministri që e kan nënshkruar me kohën kur na jemi futur në fushat zgjedhore, dhe po ashtu fatkeqësisht është 1 ministër, i cili po kërkon me u penalizu këta 2 ministra dhe këtë barrë jemi duke e bartur ne, nuk na ka pyetur askush sikurse nuk po i pyesin ndonje kryetar të subjekteve politike tjetër që nuk është i subjekt tim por shikoni të gjitha komunat hyni analizoni qfar ka ndodh dhe kjo është fenomen i keq, është jo i keq, po është më i keq se sa që mundesh me shpjegu me gojë edhe me fjalë.

Hajdar Sutaj

Alebsa për replikë është lajmëruar fillimisht nëse Albesa dakordohet për mos me fol duhet me ta kalu fjalën ty në rregull Miftar Ahmetxhekaj.

Miftar Ahmetxhekaj

Kryetar Hyrija tha pak unë dua pak më korrekt me qen të gjithë jemi të vedishëm për kontratën kolektive nuk është problemi te kontrata është përtej kontratës kolektive për këtë ne në një far forme po kemi problem me raportin pse nuk po e specifikoni. Shpenzimet te kontrata kolektive, vendimet gjyqësore kllapa kontratë nuk është e vetmja kontrata kolektive, keni shpenzime të tjera një prej tyre a bënë e pashë te drejtoria për bujqësi a ka inpakt kontrata kolektive në drejtorin për bujqësi e cila i ka 50.000 euro ose ju keni krijuar detyrime po supozoj me zyrtarë të caktuar të cilët ti ke krijuar një marrëdhëniet detyrimore dhe atij zyrtari të nderuar nuk ja keni rrespektuar kontratën nuk i ke paguar dhe ai ty ti ka marrur parat me përmbarim, nuk po du më ndëgjo unë e kam nga natyra nuk flas për subjektet, flas për fenomenet, dhe e 2-ta kryetari të fundit e kam te këto ligjerimet, ndëgjom ne jemi kshilltar komunal, te ligjerimet edhe nëse e bëjmë binduni që kemi me i përzgjedh me kujdes ne e caktojmë.

Hajdar Sutaj

Miftar faleminderit shumë kryetari e ka fjalën ti ja kalove kolegës, kryetari e ka fjalën pastaj drejtoresha për buxhet dhe financa.

Bashkim Ramosaj

Jo nuk po besoj që duhet në rast se nuk po foli qartë mundem edhe ndonjë përkthys me sjell nuk po di si me fol më shqipë, e thash me kujdes isha shumë i sinqert në atë që e thashë, thashë që jam për me i ulë shpenzimet në çdo kategori dhe thashë që jam impenjuar personalisht me pas ulje të shpenzimeve në çdo kategori, dhe ka ndodhë e thash edhe tjetrën që isha shumë i sinqert në rast se kontrata kolektive, zbatimi i kontratës ka ndodhur për shkak të 2 sektorëve që janë në këtë qytet, e që sektori më i rëndësishëm është sektori i arsimit që merr buxhet më shumë, u mundova me qen shumë praktik dhe shumë spjeguese në këtë temë, në rast se unë me ty e kam një kontrat, ti je kompani private ju ke nënshtruar tenderit i ke plotësuar kushtet dhe ke marr një punë në komunën që po supozojm vlera është 100.000 -150.000 dhe e ke një afat në kontrat të panit dinamik kur duhet të përfundoj kjo kontrat dhe kjo kontratë nuk guxon me u nënshkru pa qen

disponueshmëria e mjeteve buxhetore dhe pa e pas një kod të veçantë në këtë kod buxhetor ku mjetet janë të disponueshme dhe kompania sipas planit dinamik e ka përfunduar obligimin detyrimin e vet ndaj institucionit që e ka nënshkruar dhe menaxheri e verifikon dhe konstaton që puna ka përfunduar sipas kontratës atëherë kompania ta sjell një faturë dhe ti e ke një afat ligjor për me pagu këtë faturë.

Në anën tjetër, kur ti dëshiron të paguash dhe ty të del në raport se këto para ti ka marr përmbarusi për zbatimin e kësaj kontrate kolektive edhe kompania detyrohet me të dërgu në përmbarim dhe këtu janë bërë dy shpenzime shtesë, një është bërë sepse përmbarimi i kontratës kolektive ka shkuar me një urdhër gjyqësor, me një avokim me një proces dhe ana tjetër është edhe kompania e ka të njëjtën situatë kjo e ka edhe më vështirë për shkak se kjo është në obligime ndaj punëtorëve që kanë punuar në kompani dhe ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë që ka pas shpenzimet qoftë riparimet qoftë derivatet qoftë ushqimi ata duhet me hëngër me pi diçka, dhe kjo është disbalanci në rast se dikush më thot me përgjegjësi qoftë profesionale, qoftë morale që komuna e Deçanit duhet në fillim të vitit me i nda 3 milionë euro për një obligim që nuk e kemi nënshkruar ne që se kemi marr përgjegjësinë në atëherë le të më thotë dikush dhe unë nuk pres me e marr këtë veprim kurr nuk kam me pranuar kurr me marr për shkak se jemi duke jetuar në një qytet ku dëshirojm me pas një andërr më të realizuar, dëshirojm me bë një qytet që i përshtatet të gjitha moshave e sidomos për ata që po punojn e që unë jam shumë i impenjuar në këtë drejtim, Dafin kërkoj falje që ta ndala fjalën, unë e kam kërkuar një mirëkuptim edhe nga ju për shkak se dje e kam pasur një operim të sinusve që duhet me qen edhe sod, por erdha për shkak të këtij raporti me rrespektu, edhe atë po e presim dhe më duhet me lëviz ndërkoh.

Hajdar Sutaj

Faleminderit kryetar, drejtoresha për buxhet dhe financa Dafina Cacaj e ka fjalën.

Dafina Cacaj

Faleminderit kryetar faleminderit kryesus, unë dua të përgjigjem për hirë të transparences dhe pozitës se me të vërtetë nuk po më kuptoni asnjëherë, jo se nuk po më kuptoni por nuk po dëshironi mem kuptu, janë këto pyetjet e juaja që disa herë jam përgjigjur sidomos për telefonin mobile që kanë qen obligime të vjetra i kam paguar në fillim të vitit edhe të gjitha të tjerat e disa herë që jam duke u përgjigjur, te lista që kam pasur për ta sjell për përmbarimet nuk ka qen gati nga zyra e avokatit, si të është gati ko me jau percjell në imell të gjithëve për ta parë kontratën kolektive ose cilëndo qoftë.

Te përmbarimet dëshiroj edhe një herë të ju spjegoj qysh e tha kryetari nuk vendosim ne kur me na i marr paratë ndoshta nuk është obligim i shëndetësis as nuk është obligim i bujqësis ose i dikujt tjetër, vitin e kaluar e kam potencuar te ju disa herë që neve na u ka ndal qasja komplet dhe i kanë marr mjetet nuk jam unë kunder se ato janë obligime tona me dëshirë ose pa dëshirë tonë por që nuk është duke na pyetur ne letrat ku me i marr ato mjete bile bile këtë vit ka dhënë ministri vendim që në kategorinë e pagave mos me u prekë mjetet por në kategorit e tjera në fillimit të vitit mu mi kan marrë subvencionet edhe mallra edhe kapitale kudo që ata i kan gjetur të lira për momentin për me përfundu obligimin që ka qen kontraktual edhe pse shumica janë të shujtave, kontraktuale ka shumë pak edhe kjo ndodh për arsyen qysh e tha edhe kryetari, ne i kemi planifikim me fillu punimet tani munden me na i marrë, dhe na i kan marrë edhe me urdhërblerje na i kan marrë deri në momentin që e bën shpenzim, na i kanë marrë dhe diçka që nuk ka ndodhur në vitet e kalume, por ka ndodhë vitin e kalum edhe këtë vit është ka ndodhë të njëjtën kohë si ka dal buxheti na i kan marrë neve mjetet, ne kemi zotuar ata i kan marrë dhe vetëm kur kemi shkuar te shpenzimet e kemi par që nuk i kemi, nuk është diçka që na kemi qef me na ndodh se jeni duke u kapur në këtë pik që po mendoni që është mir me ndodh ose me shku dikush në përmbarim, për mua kur i kam mjetet është shumë mirë me i përfundu. Raporti nuk mendoj që ka raport ma të qartë dhe më në rregull sesa që është ky që ju ka ardhë edhe në secilin raportin nëse nuk ma obligon ligji, une nuk e bi edhe nëse nuk është në rregull, nuk e publikoi se edhe unë më pas kontroll kom me pas auditorin ka me vlerësu edhe ai, i keni 3 modele të raportit të publikume që asnjë komun nuk i bënë vetëm ne, që un i publikoj në webfaqe dhe mundeni me i pa janë edhe pasqyrat financiare që mundem me jau sjell muajin tjetër mundeni edhe ato me i analizu nëse ju duken ma të qarta se sa këto faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtoreshë, Albesa e ka fjalën për shkak të replikës po një minutë

Albesa Cacaj

Atëherë kryetar sa i përket deklarimit tënd në lidhje me ligjëratën, ti gjithmonë pasionohesh jo që nuk e kam përgjigjen e duhur në lidhje me deklarimin tënd, por sinjerisht me ironi edhe më arrogancën që ti përfaqëson unë nga përfaqësimi im dhe i partisë që vimë nuk mundem me tu kthi në të njëjtën mënyrë kështu që këtu po e përmbylli faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit nga ata që nuk kanë diskutuar a din mos më keqkuptoni sinjerisht, po bi në kundërshtim me vetveten, me rregulloren që e kemi miratuar, e keni pasur të drejtën e fjalës, jo nuk e patë përderisa nuk është cekur si emër, a ka dikush nga ata që nuk kanë diskutuar, atëherë meqenëse nuk ka të tjerë që nuk janë të lajmëruar për fjalë prej atyne që nuk kanë diskutuar e kalojm, domethanë si pikë dhe kalojm në pikën shqyrtimi i raportit të punës së kryetarit nga grupit i Aleancës, kush e ka fjalën? Arjan Dobraj shefi i grupit.

Arjan Dobraj

Faleminderit Hajdar, përshëndetje edhe njëherë për të gjithë, raporti i kryetarit, raporti i punës së kryetarit për vitin 2024 e dimë që përfshi një raport të përmbushur me aktivitete, detyrime të përmbushura, shërbimet e kryera, shpenzime të përmbledhura si dhe shënojnë 1 kapitull vjetor të punës së kryetarit Ramosaj për vitin 2024.

Ne në parim e përkrahim këtë raport në formë e cila ka ardhur e përgëzoj kryetarin Ramosaj për punën dhe për realizimin e projekteve, të cilat janë gjithmonë në të mirë të qytetarëve të komunës së Deçanit nëse kanë diçka kolegët me shtu ju japë fjalën faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Hyri Dobrunaj nga grupi i Ldk-së

Hyri Dobrunaj

Edhe unë shumë shkurt për mos me u pajtu me Arianin ... unë personalisht nuk dua me diskutu për këtë raport për arsyen që diskutuam më përpara, ky raport është një raport që kryetarja e ka obligim si dokument me përmbush, ligjore e ka bërë mirpo kurgjo nuk është realizuse 4.800.000 e sa mijë i ka marr përmbarusi, nuk ka pasur para edhe sikur te donte, kështu që më vjen keq por për qata nuk dua të diskutoj se atëher mundem me u keqkuptu mundet me thënë dikush që nuk po kuptoni por unë e kuptoj që kur nuk ka para ska raport ajo është vetëm fazë për me përmbush një detyrim ligjor.

Hajdar Sutaj

Nga grupi i Vetvendosjes Orgesi.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesisht përshëndetje për kolegët fillimisht ndoshta edhe kish me qen mirë që këto tema raporti analitik financiar dhe raporti i kryetarit me pas një diskripanc kohore edhe do ta kishim pasur më lehtë të diskutonim për shkak edhe debatit të mëhershëm, unë e morra fjalën për dy qështje, e para është për ti përgëzuar mjekët tanë për punën që po bëjnë njëkohësisht edhe pedagogët, mësuesit për punën e tyre të mrekullushme për pjesën tjetër po ua lë kolegëve faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges, Mon a dëshiron të flasësh? Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesisht, në këtë raport të paraqitur për punën një vjeqare të kryetarit në mënyrë kronologjike na paraqiten të dhëna dhe statistika, duke filluar nga organizimet protokolare, takimet e ndryshme të kryetarit, kërkesa, kontrata, marrëveshje, momerandume, shkresa etj.

Gjatë leximit të këtij raporti kam hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje me këtë raport, për shembull në faqën 4 thuhet gjatë këtij gjashtëmujori të parë të vitit 2024 kemi nënshkruar 11 kontrata publike dhe kemi filluar punimet në projekte të ndryshme dhe unë isha në dilemë tani a është ky raport gjashtëmujor i kryetarit apo raport 1 vjeçar i kryetarit?

Po ashtu në faqën 13 ku flitet për zyrën e auditorit të brendshëm, kjo zyrë na e paraqet disa rekomandime të cilat janë zbatuar 21.13 të pazbatuara, ndërsa numri i rekomandimeve të pazbatuara janë 10 dhe jepi arsye një arsyeshmëri me cilët thuhet se është problem përcjellja e plementimit për arsye se asnjë nga njësitë e audituara nuk ka përpiluar planin e implementimit të rekomandimeve zoti kryetar kjo fjali apo ky arsyetim haset në të gjitha raportet paraprake dhe haset te raporti i auditorit të jashtëm prandaj kisha kerku nga ju sepse edhe ligji për vetëqeverisjen lokale iu ka dhënë kompetenca të mjaftueshme që të ndërhyjnë në zyrat në varësit e juaj dhe të kërkon afate kohore për implementimin e këtyre rekomandimeve. Ju e dini që përmes këtyre raporteve apo përmes këtyre rekomandimeve të pazbatuara atëherë ne po bëjmë edhe në raportin e performancës në raportin e transparencës dhe këtu po dalim dobët në nivel qendror në rangimin e komunave me performancë, prandaj ju kisha lutë që njëherë të kërkon në mënyrën më serioze ta rrethojmë ndoshta edhe tavolinën që ta tronditni pak këta zyrtarë komunal, të cilët me neglizhencën e tyre po na paraqiten edhe juve si udhëheqës i kësaj komune edhe komunës në tërësi që nuk jemi efikas në përmbushjen e detyrimeve. Vazhdoj tutje në faqen 27, te drejtorja e urbanizmit në paraqiten përmbledhje të aktiviteteve dhe të arritura vetëm për 6 mujorin e 1-rë të vitit 2024 të paraqitura përmes tabelave, atëherë pyetja është e evidente ku janë 6 muajt e fundit?

Faqe 33 këtu raportohet për hyra financiare nga gjërat në trafik dhe gjërat nga gjykata, ku këtu thuhet citoj, të hyrat vetanake në periudha mujore dhe në total për periudhën 9 mujore që bien në kundërshtim me tabelën e ofruar.

Në faqen 110, 111 po ashtu bëhet fjalë për një raport 6 mujor kur flitet në vazhdimin e kontratave për lokalet afariste dhe transporti publik, këtë e dëshmojnë tabelat e ofruara në këtë raport dhe në fund në faqen 128 edhe këtu drejtorja për zhvillim ekonomik na paraqet një raport 6 mujor për zhvillimin dhe promovimin e turizmit në komunën tonë, të nderuar kolegë pa dashur të mohoj punën vullnetin dhe angazhimin e kryetarit dhe stafit të tij, për të sjellë para kuvendi dhe qytetarëve 1 raport sa më përmbajtësor e jo një raport si ky ose kur shkojmë market e me ble neskafe 3 në 1 domethënë janë të përfshim në këtë raport, 3 raportet 6 mujore, 9 mujore edhe 1 vjeçar për këto çështje që i ngrija do të kisha dëshiruar zotri kryetar ose kush mundeni nga ju me ma dhënë një përgjigje ju faleminderit.

Hajdar Suta

Mon faleminderit, kryetari i komunës Bashkim Ramosaj e ka fjalën.

Bashkim Ramosaj

Për situatën e mishmashit nuk di as vet me spjeguar ndoshta edhe krijohet kjo përshtypje ndonjëherë në këto raporte po mundohem me japë përgjigjen te auditori i brendshëm, auditori i brendshëm janë pjesë e zyrës time janë kolegë të mi ja në varësi timen e kanë autonominë e vetë të patjetërsueshme që nuk mundesh as me ndërhy, te auditori i brendshëm nganjëherë edhe unë nga pozita e kryetarit e kam për obligim që me ju thënë me bë këtë raport kështu që me mbajt njëfar standardi dhe po besoj që auditori edhe i brendshëm dhe i jashtëm, sidomos auditori i jashtëm që jemi ne obligim edhe për matje edhe për performancë edhe për penaltitetet të mundshme besoj që jemi më të kujdesshëm, mirëpo po për ditë e bëjmë këtë punë që me i plotësojmë me i përmbushë rekomandimet dhe sugjerimet që vijnë nga auditori i mbrendshëm sidomos. Në këto raportet se si përpilohen dhe se si hartohen ndonjëherë as unë nuk pajtohem me to sepse e kanë një paqartësi edhe për mua kur zyrtarët mi sjellin të dhënat që duhet me i futë brenda një raporti të përbashkët me i integru nuk kanë ndonjë qartësi po të them një diçka të fundit nesër ne kemi me qenë pjesë e 1 konference që mbahet në Pejë dhe jam tepër i kënaqur për shkak se është ardhur një vlerësim jo nga ne, jo nga Deqani, jo nga njerzit e Deqanit por që është shumë i pavarur si vlerësim, ku Deqani renditet ndër komunat e para është numër një e sa i përket zhvillimit ekonomik në konceptin në sektorin e promovimit dhe të turizmit, për shkak se ka lëvizje shumë pozitive dhe trendet janë shumë pozitive, pavarësisht që ne ende nuk kemi arritë me kriju shërbime dhe oferta të sakt dhe standarde për këta vizitor spaku pjesa jonë në këtë farë pjesë ka qenë e kadalshme ka pasur mungesa edhe të burokracisë edhe norma ligjore që të kanë penalizuar tek e fundit nuk ka dikush që ka ndërtuar diçka dhe nuk është i ftim prej sistemit tonë gjyqësor që me jap një përgjigje se është njëfar demotivimi për me bë diçka më të rëndësishme dhe më të madhe, faleminderit për vërejtjet dhe faleminderit për sygjerimet do ti kemi parasysh.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kryetar, e kalojm edhe këtë pikë a pat të tajmëruar, nuk më është lajmëruar askush, në rregull kush është i interesuar, nuk isha duke e kaluar por nuk është lajmëruar askush Vatoni Istrefaj, Albese pastaj.

Vatoni Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesues, së pari për të dalë transkriptimi më në fund në rregull dhe për të mos ta diskutuar në herat e ardhshme, është mirë që kur flet dikush ta ketë mikrofonin ndezur kryesues le të jetë si traditë të mos flasin të tjerët, kur i kemi mikrofonat e ndalur, pasi që transkripti nuk e merr përpilimin e duhur të fjalive, po ashtu sa i përket raportit të punës 1 vjeçar të kryetarit po filloj nga fjala hyrëse e kryetarit të komunës ku dua ta citoj 1 fjalë të tij duke thënë kështu, premtoj se do të jem përgjegjës para jush qytetarë të komunës së Deçanit, duke raportuar dhe duke marrë bazë kërkesat dhe rekomandimet tuaja.

Pyete veten kryetar njëherë personalisht për mbi 5 seanca komunale i kemi që të bëjë lutje të bëj thirrje qëndron tek pika e të ndryshmeve, ti bëjm pyetjet tona, rekomandimet dhe kërkesat, siç shihet kryetar që 5 seanca nuk ke gjetur kohë, ndonjë seancë ndoshta ka edhe arsye si për shembull kjo e sodit ke pasur një intervenim shëndetësor diçka tjetër kuptohet, por në seancat e tjera që 5 seanca kryetar unë personalisht nuk kam mundur me ta bë asnjë pyetje të cilat i kam marrur drejtëpërdrejt nga qytetarët, pra kryetar kur të thua një fjalë këtu është mir ti qëndrosh mbas, nuk pajtohem me disa punë që janë cekur si të kryera në raport e realisht nuk janë të kryera, si për shembull ndalem tek kontrata në shtëpi që e ka komuna e Deçanit me higjienën në raport në faqen 110 cekët që përmes kontratës shpi po bëhet mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, lapidarëve dhe varrezave publike.

Personalisht nga lokaliteti që vijoj unë dhe aty përreth asnjëherë higjienën përmes kontratës shpi nuk e kam parë duke bërë mirëmbajtjen e këtyre varrezave faleminderit.

Hajdar Sutaj

Albese Cacaj.

Albese Cacaj

Atëherë përshëndetje edhe njëherë, siq e thanë të gjithë parafolsit ka edhe në këtë raport shumë pasaktësi, sidomos në çështjet që ka vite që i përcjelli, fillojm ka zyra për komunitete e kthim ku në këtë raport është i pranishëm konstatimi se nga drejtorët e shkollave në faqe 17 nga drejtorët e shkollave, të cilat ne si komunitet për komunitete i kemi vizituar Rexhep Kadrijajn në Rastavic dhe shkollën fillore Drita në Gramaqel këtu sipas këtij raporti konstatohet se gjendja është shumë e mirë me arsimin dhe nuk ka braktisje të shkollave e që në realitet nuk qëndron kjo situatë edhe pse ne kemi konstatu situatën në terren dhe kemi ngritë çështjen te strukturat të cilat kanë përgjegjësi për të ndërmarrë veprime qështja ka vite që mbetet e tillë, pra kjo flet që e shifni un e kamë marrur nga drejtori i shkollës në Rastavicë që konstaton se ka braktisje të mësimi të rregullt nga nxënësit nga komunitetet, pra numrit është gjithsej 7.

Pastaj ajo që dua të shtroj si pyetje, e keni konstatuar edhe këtu kryetar në këtë raport, mirëmbajtjen e hapësirave dhe sipërfaqeve në tërë territorin e komunës së Deçanit të paktën 2 herë në vit, pra i largoni deponit inerte, deponitë e mbeturinave etj. Unë kam marrur fotografi, siq e kam ngritur çështjen edhe në marsin e vitit të kaluar dhe e njëjta situatë është edhe në shkurtin e po këtij viti dhe më thoni jo që ju 2 herë po asnjëherë nuk keni marrë veprimet që të përmirësohet dhe të largohen këto mbeturina nga ajo sipërfaqe. Pastaj në faqen 108 mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik kjo çështje është ngritur disa edhe nga kolegja nderuar Blinera nga vendi, nga ajo ku vjen edhe gjatë gjashtëmujorit të 1-rë të vitit 2024 ka vazhdu thotë zgjerimi i ndriçimit publik eficient në fshatrat dhe vendbanimet e komunës së Deçanit, pyetja është për gjashtëmujorin e 2-të a është bërë ky shtrim i zgjerimit të ndriçimit publik edhe sa për afërsisht është sipërfaqja.

Pastaj kryetar e ke theksuar këtu në këtë raport eliminimin e deponive ilegale as kjo nuk qëndron fare mirëmbajtjen e hapësirave publike, shpesh e kemi theksuar kur vjen koha e vegjetacionit, prerjes që e ngushton rrugën, drejtori i shërbimeve publike ka thënë që nuk është koha në pranver por në shtator me ironi edhe ai se keni kështu si lloj tradite.

Çështja jetër...

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë për gjithë kontributin tënd të jashtëzakonshëm, është lajmruar për fjalë, jo jo të lutem edhe je duke na fyer edhe me ta dhënë fjalën pak si teper kush ishte në rend, a je e sigurt vetëm edhe kësaj radhe më mos e thuaj mate herav të tjera fjalimin.

Albesa Cacaj

Qfar kisha dashur nga 45 projekteve të parapara për tu realizuar në vitin 2024, 24 kanë qenë në vazhdim ajo që du me dit është saktësisht cilat projekte kryetar pse nuk i ke saktësuar edhe theksuar këtë raport që janë kry cilat janë vazhdim edhe po nga 2021 në vazhdim prandaj po kërkoj një lloj transparence, faleminderit.

Hajdar Sutaj

A ishte dikush i lajmëruar për fjalë disi Miftar të lutem se edhe flet.

Miftar Ahmetxhekaj

Uroj ta kesh pa inyoranc, faleminderit shumë kryesus, kryetar pa dasht të ndalem shumë në gjërat më specifike, kështu te raporti zakonisht raportet janë kur ti i pasqyronë rezultatet mbi.. kur i pasqyron në një raport objektivat të cilat ti ja ke vendosur vetëvetes paraprakisht, pashë projektet të cilat janë në vazhdim pjesa dërrmuese dhe raportin e dominon më shumë çështjet protokolare të cilat për neve, mund të jenë për ju të rëndësishme por për 1 raport të punës për ne si këshilltarë janë punë që janë punë ditore ose punë mujor. Kur thashë objektivat ka kohë që pres në raportet e juve eventualisht nëse po i shoh disa objektiva për të cilat ju ja keni vendosur vetëvetes qysh në vitin 2021, dihet se Deçani është duke vuajtur për 2 fenomene shumë të rëndësishme. Ju keni premtuar ndërtimin për kanalizim për 18 fshatra me bazena impiante pastruese dhe pres me padurim që kur po e shoh një projekt të tillë të paktën të filluar dhe e 2-ta jo vetëm Deçani po dhe Kosova është duke vuajtur për ujë dhe po pres këtë digën në Lloqan kur keni... për shkak se mbi bazën e këtij premtimi e keni marr edhe votën kur pres që te pakten të shoh në një raport të punës së kryetarit të Deçanit që ky projekt ka filluar të implementohet faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Miftar, kryetar fjala për ju.

Bashkim Ramsaj

Faleminderit kryesus, po filloj prej shqetësimit të fundit besoj që edhe parafolli është në dijeni të këtij fakti. Ajo që unë dal në fushat me të dhe premtoj ose nuk e premtoj ose mënyrën qysh e themë ose objektivat që ia vendosi vetës normal që jamë përgjegjës unë mirëpo që është mirë me më interpretu drejtë në atë që e premtoi ose e them në objektivat që ja kam vendosur vetës, komunës për një 4 vjeçar ose për ma gjatë e kam shpjeguar edhe këtë në këtë asamble më shumë se 5 a 6 herë ose në çdo raport pune që e kemi bërë sepse ka qen shqetësimi thuajse i njëjtë.

Ka qenë prilli i vitit 2021 kur janë anuluar 2 kontrata, 2 linja buxhetore të cilat kanë pasur të bëjnë me rajonin e Vokshit e deri me () dhe po ashtu në rajonin e Strellsit e deri në Lumbradh duke i përfshir Libush, Isniq, Gramaqan, Dubovik, pjesën e () që janë ato fshatrat andej dhe këtu janë anuluar 2 kontrata për shkak, sepse nuk ka qenë buxheti komplet i sigurm kështu na është thënë dhe kjo e mban një datë mban një protokol e mban një shënim pse ka ndodhur nuk jam fajtor unë për këtë unë e kam bërë punën maksimalisht për shkak se janë projekte të detajuara dhe këto projekte ka qenë shumë e vështir për ti hartuar me i bë sipas standardit. E 2-ta sa i përket pendës akumuluse jam tepër i lumtur dhe po ndihem shumë i përmbushur që është një nga projektet të para që ne e kemi bërë si komunë dhe është projekti po ashtu më bashkëkohor dhe më me standard që nuk ka mbetur institucion qoftë i nivelit shtetëror qoftë i nivelit ndërkombëtar që nuk e kemi prezantuar para tyre dhe nuk mundem që të pretendojë projektet të cilat kapin shifrën projekti i parë për kanalizimin e impiantit kap shifrën dikund 150 milion euro dhe projekti i 2-të e kap shifrën diku më shumë se 60 milion euro pa hyrë në pjesën e implementimit nëpër fshatra sa i përket pendav akumuluse mirëpo që a kam për të hjekur dorë ndonjëher a ka mi pasur gjithmon premtin a ka mi pasur disa tema a ka mi pasur

perkushim timin normal qe ko me i pasë dhe nuk i sygjeroj ndokujt qe me hjek dorë nga këto projeksione qfare do qofshin ato po më vjen keq kam për tu siguruar për nje temë të caktuar qe ka të bëjë me kontratën në shpi ku janë varrezat dhe ku janë hapësira publike ose edhe lapidarët ose komplekset qe i kushtohen martirëve dhe dëshmorëve të kombit nuk besoj qe ka guxu me nd odh kjo dhe nuk jamë shumë i sigurt, por në rast se ka ndodh, në rast se ka ndodh kjo është gabim, dëgjo se nuk po du me.. kryesus, nuk dua të futem në detaje me datën 9 ka përfunduar fushata ka fitu ai qe ka fituar nuk jemi në fushat zgjedhorje jemi në asamble komunale ku flasim për tema profesionale dhe ku adresohen, sepse dikush duhet të mirret në pyetje nesër pse nuk i ka bërë veprimet në një lokalitet të caktuar. Avazi i njëjti unë mundem me toleru edhe në emrin tim me u quajt me ndonjë emër pa problem nuk është krejt e ndershme po bën, nuk është fundi i botës po nuk besoj qe jam përgjigjur ndonjëherë me injorac ose me ndonjë temë tjetër jam munduar me qen shumë i sinqert sidomos me ju. Po flasim për mbeturinat dhe po flasim për vegjetacionin i cili po na nxjerr telashe kam kërkuar shumë moti po besoj qe jemi në prag të miratimit të një rregullore, e cila kam fjalën vetëm për mirëmbajtjen e vegjetacionit qe ka të bëjë me rrugë qofshin ato komunale, sidomos jo për rrugë qe rajonal ose qe janë kompetenc e ministrisë së infrastrukturës mirëpo mjaft na dalin këto të tanat ne ndoshta kemi nevojë me prek pak ndërgjegjen tonë si në aspektin e mbeturinave sepse dikush hek dhe kurr një nga ne nuk e pranojmë qe i hudhim këto mbeturina krijohet përshtypja qe Ufot na vizitojnë shpesh edhe i zbarkojn dikund edhe ikin, mirëpo kur e bënë një ndryshim duhet me i qëndru shumë afër dhe më qen shumë rezistent në ato qe po don me mrri unë po besoj qe kemi tregu këtë far teme në raport me mbeturinat dhe njëkohësisht kisha pas qefë me prekë ndërgjegjen qdo bashkëvendasi tanë qe e ka pronën afër në rrugën qe është e asfaltuar ose e pa asfaltuar ose e ka të një ndërtese publike e kam përshtypjen qe vetëm në pjesën ku ka livadhe ose arën, kurse në pronën publike nuk e prek unë nuk kamë qëndruar shumë jasht, nuk besoj qe kam qen më shumë 7 a 8 ditë jashtë vendit po i dëgjon tregimet qe të tjerët i tregojnë për obligim qe e ka pronari i tokës në raport me pronën qoftë komunale qoftë shtetërore qoftë publike dhe ishte dashur ndoshta me u vendos njëfarë takse, data të caktume kur pronari qe e posedon atë tokë e ka në shfrytëzim ose e ka pronë të veten me dalë me kry punën e vet, ajo qe është pronë publike normal qe i bie një institucioni qoftë komunal, qofte i nivelit qendror çfarëdo qoftë dhe kjo ishte dashur me ndodhë kështu e kërkoja një nderë nga ju më herët ku thashë me më jap leje me mirkuptim kisha dashur me lëviz, faleminderit nga ju.

Hajdar Sutaj

Faleminderit kryetar, Miftar vazhdo.

Miftar Ahmetxhekaj

Në fillim të fjalimit the kamë dëshirë me më lexu drejtë nëse ke pas për pyetjet e mia, unë këtë dokument e kam siguruar nga 1 organizatë qe është Kdi-ja dhe për të cilin kamë kërkuar vërtetësin nëse eventualisht, nëse ju ke referuar kësaj është dokument për pyetjet qe i bëra janë korrekte dhe kogja mundohem me të kuptuar drejtë dhe me qen i qartë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kryetar të urojm shëndet, kryetar të urojm shëndet kaluse qoftë kjo vazhdojm me pikën e 4-t qe e keni të shënuar si pika e dytë është shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës së kuvendit 2025, kolegë sa i përket planit të punës së kuvendit, në rregull vazhdojm edhe pak, i kemi edhe disa rekomandime të cilat i ka përcjellë Kpf-ja qe ka të bëjë me raporti i zyrës për barazi gjinore raporti i komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike higjiena, raporti Qkmf-s për pos këtyre a keni diçka me shtu? Përpos rekomandimeve të Kpf-ës, po Blinera Lokaj e ka fjalën.

Blinera Lokaj

Faleminderit kryesues, sa i përket planit të punës së kuvendit, unë propozoj qe të na vijë për shqyrtim edhe raporti i zbatimit të planit të integritetit

Hajdar Sutaj

Në cilin muaj e propozon.

Blinera Lokaj

Kudo që ka hapësirë më shumë për shembull qershor.

Hajdar Sutaj

Raporti i punës apo zbatimet.

Blinera Lokaj

Zbatimet kurdo që ka më shumë hapësirë, faleminderit.

Vatan Istrefaj

Po kryesues, personalisht i kam japur 2 rekomandime në komitetin politik financa, a ka mundësi që të, përfundoje njëher pastaj

Hajdar Sutaj

Më falni.

Vatan Istrefaj

A ka mundësi që tek kërkesa ime që kam bërë që të jetë një raport i drejtorit të Qkmf-ës në kuvendin komunal, pasi ne jemi themelues të Qkmf-ës, besoj se është bërë 1 gabim teknik në propozime, është shkruar vetëm raporti i Qkmf-ës, unë kam kërkuar që të vijë drejtori i qendrës kryesore të mjekësisë familjare 1 herë në vit, saktësisht në muajin tetor nëntor kur nuk kemi shumë pika dhe ta bëjë 1 raport rreth gjendjes ekzistuese të qendrës kryesore e mjekësisë familjare në Deçan faleminderit, besoj jemi edhe themelues të sajë.

Hajdar Sutaj

Realisht na nuk bëjmë planin e punës për çdo vit për vitet në vijim e për këtë vitë jemi dakord nuk kemi pasur ndonjë kundërshtim sa i përket, raporti kështu ka qenë i Qkmf-ës në rregull e kjo e dikush tjetër diqka Albesa a kishte diqka për të shtuar, po gjithsesi Albesa Cacaj.

Albesa Cacaj

Unë do të doja të rekomandoja që në planin e punës për vitin 2025 të jetë edhe pika plani i veprimit të këshillit rinor lokal, a e ke kërkuar? Po barazia më lejoni të përfundoj, nuk e pasna pa po po e di që edhe herën e kalimeve vitin e kalim i kam kërkuar janë miratuar por asnjëherë nuk janë ardhë për tu raportuar kështu që kisha bërë apel kisha kërkuar që kryesuesi i kësaj here të jetë më i saktë dhe në nivel të detyrës dhe që të kërkojë që pikat e rendit në të cilat parashikohen të paktën ose po zvarriten për një muaj ose muajin tjetër ose pas 2 muajve të vinë dhe të diskutohen faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Albesa dikush tjetër, e qes në votim planin e punës kush është për? Po absolut me ndryshimet edhe të Kpf-ës edhe ndryshimet që propozohen

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatohet se kuvendi ka miratuar planin e punës së kuvendit, jemi te pika e 5-të, e 3-ta e keni të shënuar në, është shqyrtimi dhe miratimi i planit të Kksb-ës për vitin 2025. Antigona, Gentiana Ibërhyasaj Mazreka e ka fjalë në knaqësi faleminderit shumë.

Gentiana Ibërhyasaj Mazrekaj

Nuk ka dertë zakonisht më ngatërron me Dafinën, përshendetje për gjithë, atëherë si koordinatore e Kksb-ës para jush e kam paraqit draftplanin vjetor të punës këshillit komunal për siguri në bashkësi, cilin veç e keni përfshin temat dhe muajt se kur është planifikuar të mbahen takimet ju njoftoj se këtë vit do të mbahen edhe

procesverbale pak më të gjëra, të cilat do të publikohen edhe në faqën e komunës si dhe kemi planifikuar që 2 herë në vit të raportohet para jush rreth ecurisë së Kksb-ës nëse keni diçka këtu jamë.

Hajdar Sutaj

A e përfundove, unë të falënderoj shumë jo të dëgjova dhe të përgëzoj edhe për propozimin, te pika 2-të e rekomandimeve i keni dhe rekomandimet e Kpf-ës, a keni diçka përpos rekomandimeve të Kpf-ës me shtu tek ky plan ose te propozim draft plani i Kksb-ës për vitin 2025, Hyri Dobrunaj.

Hyri Dobrunaj

Planin për këshillin për sigurinë në bashkësi i kemi dhënë rekomandimet tona mirëpo sot një far lloj rekomandimi kish me qen që në atë këshill ish dasht me marr pjesë edhe Shtëpia e social, drejtori i entit social, po.. urdhëro.. qendra për punë sociale meqenëse ajo qendra për punë sociale merret edhe me trajtimin e rasteve të miturve kur ndodhin, kemi fol për dhunë në familje që duhet me shti një vitë në diskutim, edhe pse ndoshta është pak 1 herë në vit, ka nevojë për më shumë herë mirëpo unë besoj që duhet edhe qendra për punë sociale meqenëse ata mirren me problematikat e të miturve pjesë e këtij këshilli, përbërjen e këshillit komunal, me qen edhe..

Hajdar Sutaj

Kështu për hirë të transkriptit kur nuk është mikrofonin ndezë nuk regjistrohen fjalët, a përfundove Hyri a mundet me tu përgjigjë.

Hyri Dobrunaj

Po besoj e përfundova.

Hajdar Sutaj

Mundesh me u përgjigjë atëher e ndizni mikrofonin në foltore mundësisht te Gentijana.

Gentiana Iberhysaj Mazrekaj

Për vendimin e këshillit komunal është rregullorja për këshilla e cila i cakton se kush ka me marrë pjesë dhe përmbamja e tyre nëse nuk paraqet asnjë problem patjetër se është mirë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kështu nese është e mundshme, mos rri në këmbë ulu këtu afër se po më vjen keq, e ka kërkuar fjalën Orgesi dhe Yllarta pastaj Blinera edhe kisha sygjëruar nëse ti je dakord që mundesh me u përgjigjë pas çdo folësi por nëse dëshiron mbaj shënim dhe në fund ju përgjigjesh të gjithëve, Orges Tafilaj e ka fjalën.

Orges Tafilaj

Më shqiptove emrin gabim ma ndrove gjinin se e bëre Orges realisht edhe bisedimet e mëhershme, debatet që kemi pasur me kryetarin kamë kërkuar që për 2 pika me pas kujdes të shtuar meqenëse je koordinatore Kksb-ës kisha kërkuar që me ju kërkua policisë së Kosovës, meqenëse marrin pjesë në takimet me ju që të kenë patrollim ndoshta më shpesh në orarin kur nxënësit janë në shkollë në mënyrë që të eliminohet sa ma shumë njerzë që shpërndajn drogë ose diçka tjetër dhe e 2-ta shpejtësia e madhe që po zhvillohet dhe garat me makina, sidomos në atë pjesën te Carabregu dhe në pjesën tjetër fatkeqësisht po vërehet edhe tek rruga që të dërgon deri tek ai post blloku i 1-rë i kforit në rrugën ka manastiri, është vërejt që janë dëmtuar edhe pjesë mbrojtës anash rrugës kështu që ju kisha sygjëruar që ti merrni parasysh së bashku me policinë të kontriboni në këtë aspekt për të mirën dhe sigurinë e qytetarëve faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges, Yllarta pastaj Blinera, Yllarta Thaqi e ka fjalën, kështu kërkoj falje teknikës për shkak se kjo e ka ndërruar vendin sot, ka pasur dëshirë me ndërru vendin, dëgjomëni kënd e ke njoftuar Lënditen e ke njoftuar a? te Lëndita Berisha e ndezni mikrofonin a te Floriana kush ulet zakonisht aty? Te mikrofoni Floriana Hulaj ndizne vazhdo.

Yllarta Thaqi

Faleminderit realisht për planin e Kksb-ës dua të ju përgëzoj dhe me qenë koordinatore e kksb-ës nuk është pak sepse është 1 organ shumë i rëndësishëm pasë asamblesë komunale Kksb-ja mundet me nxjerr edhe vendime në të mirë të komunitetit dhe kryetarit.

Sa i përket planit të Kksb-ës që i kemi dhënë edhe rekomandimet tona tek Kpf-ja përtë të cilat mendoj se ato të cilat kanë qenë të nevojshme, duhet të inkorporohen në plan nuk do të thotë që të gjitha rekomandimet të inkorporohen në plan. Njëkohësisht e kam pas edhe 1 kërkesë po le të mbetet në transkript tek drejtorja për buxhet dhe financa edhe tek zyra e kryetarit që anëtarët e jashtëm të këshillit komunal për siguri në bashkësi fillimisht anëtarët e jashtëm të paguhen për arsye se ata nxjerren prej një pune edhe detyrohen që me ardhë në një punë tjetër njëkohësisht japin edhe kontributin e tyre aty, e gjejnë zgjidhje për anëtarët e jashtëm mandej edhe për anëtarët e brendshëm tu pa tu bo thojnë edhe kemi modele komunat e përafërta, përndryshe rekomandimet shpresoj se do të mirren dhe ju urojmë punë të mbarë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Yllarta, Blinera Lokaj.

Blinera Lokaj

Faleminderit kryesus, atëherë shpresojmë që plani të zbatohet dhe të ndiqet progresi përmes raporteve të rregullta dhe takimeve të Kksb-së unë propozoj vetëm tek qëllimi Kksb-së te palët e përfshira të shtohet apo edhe të cekët përfaqësues të shkollave dhe institucioneve arsimore meqenëse janë cekë policia, bashkësia fetare, shoqëria civile, vetëm të shtohet edhe kjo pjesë institucionet arsimore, meqenëse ky plan ka të bëjë edhe me sigurinë në shkolla, jo te qëllimi nuk është i specifikuar veq të cekët apo të shtohet faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Blinera, a ka të lajmëruar të tjerë për fjalë? Gentiana a ke me shtu diqka, atëher koleg me rekomandimet që i ka përcjell Kpf-ja edhe këtu që i thanë sod kolegët e qes në votim planin e punës të Kksb-së kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

E nderuara Gentiana ju përgëzojmë për punën që keni bërë dhe ju urojmë punë të mbarë e suksese faleminderit shumë gjithashtu dhe juve. Jemi te pika e e 6-të shqyrtimi i raportit të punës një vjeqar të komitetit të komuniteteve, zotri Shkëlzen Berisha, fjala për juve në foltore mundësisht.

Shkëlzen Berisha

Faleminderit kryesus përshëndetje për të gjithë unë jam kryesues i komitetit për komunitete. Komiteti për komunitete gjatë vitit kalendarik janar dhjetor 2024 ka mbajtur gjithsej 20 mbledhje të rregullta, pjesë e këtyre kanë qenë anëtar të komitetit për komunitete, zyra për komunitete dhe kthim, drejtori të ndryshme nga kuvendi komunal në Deçan, kryetari i komunës së Deçanit, Osbe-ja, Unmik dhe policia e kosovës. Gjatë këtij viti nga komiteti për komunitete janë vizituar vendbanime ku gravitojnë Komuniteti jo shumicë siq janë fshatrat Gramaqel dhe lagjja Pemnisht ku jemi njoftuar për së afërmi për problemet që përballen ky komunitet që kryesisht kanë qenë probleme të infrastrukturës, ndriqimi publik asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i rrjetit të ujërave të zeza.

Gjithashtu gjatë këtij viti janë bërë vizita në 2 shkolla ku gravitojnë më shumë nxënësit e komunitetit joshumicë, në shkollën fillore Rexhep Kadriaj në Rastavicë dhe në shkollën fillore Drita në Gramaqel. Nga drejtorja e shkollave të lartcekura jam njoftuar se nxënësit e komunitetit jo shumicë janë të integruar plotësisht, në përjashtim të shkollës Rexhep Kadriaj në Rastovicë, ku 1 numër i caktuar i nxënësve te komunitetit, jo shumicë nuk vijojnë mësimin të rregullt dhe në këtë dukuri e kemi konstatuar si komitet dhe

kemi deleguar te organi përgjegjës. Gjatë këtij viti, komiteti për komunitete ka pasur takim të natyrave që kanë të bëjnë në komunitetin joshumicë në komunë të Deçanit kryetarin e komunës së Deqanit Bashkim Ramosaj, drejtorinë komunale për arsim, drejtoreshën për buxhet dhe financa znj. Dafine Cacaj dhe drejtorin e () zotri islam Mustafaj. Gjatë këtij viti Osbe-ja ka organizuar dhe sponsorizuar aktivitete te ndryshme vizita nëpër terene në vendbanime ku në komunitete jo shumicë në komunën e Deçanit, komunën e Pejës me qëllim të shkëmbimit të përvojave të ndryshme në teren, pra ky është raporti ne pika te shkurtra, qofse ka ndokush ndonjë pyetje mundem me u përgjigjë.

Hajdar Sutaj

Shkëlzen faleminderit shumë për spjegimet nëse ka dikush fillimisht nga grupi i Aleances a keni diçka më thënë, pajtohesh faleminderit shumë e kemi edhe Elmedinen ne në grup aty, faleminderit edhe Ldk-ja ja po pajtohen se Albesa është në grup ne me komentet për komunitete. a ke deklarim, me shtu diçka, aje e sigurt, faleminderit Albesa Cacaj e ka fjalën.

Albesa Cacaj

Përshëndetje edhe njëherë atëherë faleminderit që ke gjetë kohën dhe faleminderit edhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm që kemi, është fakt i njohur që po kanë kaluar 3 vite dhe ju ka dash drejtoreshës për buxhet dhe financa me ardhë në komunitet edhe me i dëgju nevojat dhe kërkesat e komunitetit, por që nuk janë përfshirë ne planifikimin buxhetor të vitit pasues pra për 2025-ën.

Çështja tjetër që theksova braktisjen e shkollave që u fute te raporti i punës së kryetarit pastaj çështje tjetër që e kam ngrit vazhdimisht në komitetin për komunitete ka qenë mungesa e përgjegjësisë së drejtorëve të caktuar, të cilët ne i ftojmë për të marrë përgjigje në lidhje me 1 temë të caktuar dhe ata e refuzojnë, por është 1 gjë e qartë që nuk përgjigjen e nuk dinë shembull konkret është drejtori për punë dhe mirëqenie sociale, të cilin mund të themi 4 seanca e kemi prit gjersa ka gjetë kohë të vijë dhe të jetë i pranishëm dhe i cili është zotuar në bazë të përgjegjësisë të tij që të na sjellë raport, për punën për çështjen që ne i kemi deleguar, por asnjëherë nuk ka arrit kjo situatë. Pastaj çështje tjetër që dua të shtroj është se pse asnjëherë komuna e Deçanit edhe këtë e them me përgjegjësi të plotë nuk ndan mjete financiare për zyrën për komunitete dhe kthim duke i marrë parasysht edhe informatat që i kamë, që zyra për komunitete dhe kthim në Pejë, Gjakovë, Istog ndajnë qindra mijëra euro për këtë zyrë, ndërsa komuna e Deçanit jo, jo janë pyetjet që kanë të bëjnë pikërisht me raportin e që ne kurrë nuk marrim përgjigje. Po. Jo jo qytetarët, pikërisht edhe unë jam pjesë e qytetarisë, ti nuk je këtu me më tregu mu çka me fol pikërisht une e kam ngritur, jo jo kam ngritur këto çështje në komitet dhe nuk i kam marrur asnjëherë edhe është pastaj e drejta ime me i ngrit, kryesues çështjet juaja për qytetarët andej është çështje e jotja nuk më përket mua faleminderit kryesus.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, kush nga Vetëvendosja, nuk patën, Mon a kishe ti diçka për të thënë, Mon Selmanaj.

Mon Selmanaj

Kryesus nuk e di pse po më.. jo unë e ngrita dorën po kur u jepet grupeve kështu atëher ti e din se une rri i përgatitur për të gjitha pikat dhe po... nuk duhet me bo apo flet edhe ti a ke me thënë ndonjë gjë edhe ti disi po e sho pak si cinike po nejse unë jam tolerus.

Zotri kryesues i këtij komiteti elaborove raportin e muajit majë dhe në paragrafin e fundit aty ku flitet për vizitën e juaj në 2 shkolla Gramaqel dhe Restovic e kam një pyetje kështu konkrete për shkollën fillore Rexhep Kadriu Restovic po e citoj raportin, kur një numër i caktuar i nxënësve nga komuniteti jo shumicë nuk vijon mësimet me rregull dhe në këtë dukuri e kemi konstatuar si komitet dhe e kemi deleguar te organi përgjegjës. Pse nuk jeni të sakët këtu me numër që 3 nxënësia nuk gravidojnë në shkollë ose 5 ose 1 ose aty, raportet duhet të jenë të sakta, jo hamendësime. E 2-ta hamendësimi tjetër është që e kemi deleguar te organi përgjegjës, cili është organi përgjegjës, organi përgjegjës është drejtori i shkollës edhe është Dka-ja drejtoria komunale e arsimit. Deri ku e keni qar këtë iniciativë tuajën ju, a e keni dorëzuar aty dhe a jeni interesuar ju me marrë përgjigje, cilat janë problematikat në atë komunitet te ata nxënës, të cilët nuk e vijnë mësimin dhe ju e dini

Hajdar Sutaj

Më falni, rrepektoni fjalën e gjithësecilit, Mon të lutem vazhdo ke të drejt me thënë mendimin tënd ky ka të drejt me tu pergjigjë

Mon Selmanaj

Ju e dini që Mësimi fillor i ciklit të ulët është obligativ dhe nëse është problematika te prindërit e këtyre fëmijëve, atëherë ata mund të jenë edhe me ligjë, a po kupton dhe ne nuk guxojmë të lejojmë asnjë njeri pa shkollë ky është mesazhi im dhe kërkesa ime që të jeni shumë konkret në punën që e kryeni ju, e 2-ta pyetje është në raportin e nëntorit, po citoj gjatë këtij muaji kemi pasur 1 rast të personave të riatdhesuar, të cilit i është ofruar ndihmë rreth procedurave të riatdhesimit, edhe përfundon me kaq. Atëherë unë e kom një pyetje nga radhët e cilit komunitet është ky person që është riatdhesu, a e keni akomoduar, cilat janë a din pak më shumë sepse ti ju jeni, ka raportoni kuvendit edhe kur nuk e din kuvendi në mënyrë zyrtare qysh ka me fol çarshia thon pastaj ka ardhur filoni ka ardhur ky komunitet, domethanë sygjërim i imi është për komitetin që në raportet e përpiluara të jeni pak më transparent pak më të përpikur dhe më të sakt ju faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Hyrije Dobrunaj, po meqenëse është duke e vlerësuar me u përgjigjë e nderoni mikrofonin në foltore për Shkëlzen Berishën.

Shkëlzen Berisha

Po raporti ka qenë pak i mangët atë e pranoj se zyra për komunitete dhe kthim i ka ndrruar pajisjet dhe nuk ka pas asnjë të dhanun të ruajtur kemi arritë disi me përpilu raportin, sa i perket nxënësve janë 7 që e kanë ndërprerë mësimin edhe ne kemi bërë mbledhje të jashtëzakonshme kemi thirr në drejtorinë e arsimit qendrën për punë sociale Prindërit, Policinë edhe kemi bisedu por nuk ka pasur efekt prap ka vazhduar vit pas viti të njëjtat familje të njëjtit nxënës kanë shkuar 2 a 3 ditë, 1 javë kanë pas arsye të ndryshme qanta e kësaj gjëra, ju kemi ofruar, Unmiki, por nuk kanë dashur me vazhdu, tash kush mundet me u marr me ta nuk e di. Ne e kemi dërguar deri aty ku kemi pasur mundësi, deri ku kemi mundur ma shumë nuk di kush mundet, kush është fajtor unë e di se prindërit më së pari, a kush duhet të mirret me ta. duhet dikush, e për personin e riatdhesuar ka qenë i komunitetit shqiptar, është marr zyra për komunitete dhe kthim ata janë marr me këtë rast po në raport ne shpesh i bëjnë të përbashkët edhe nuk e di tamam kush është ai person.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Shkëlzen, Hyri Dobrunaj e ka fjalën.

Hyri Dobrunaj

Po kryesues nuk e pata ndërmend me diskutu, sepse Albësa është anëtare e komitetit për komunitete, ne kemi diskutuar atë ditë në KpF, unë i kam dhënë vërejtjet e mija, unë mendoj se ndahet një buxhet në atë zyrë për komunitete dhe duhet me u raportu puna, ne kemi pritur vitin e kaluar se kemi diskutuar këtë raport për arsye se askush nga komuniteti ska qen me përfaqësu vetveten dhe ne mendojm që ka ardhur koha dhe momenti që ju duhet me raportin dhe duhet me punu shumë sepse komunitetet unë personalisht edhe besoj të gjithë në këtu si njerëz dëshirojm me u ndje ju të barabart me ne dhe duhet me qen të barabart, të trajtuar njësoj sikurse ne të tjerët sikur shumica, mirëpo këtu po e kuptoj nuk e di pse dikujt po i pengon me u diskutu, ne këtu jemi për me diskutu dhe për me ngritë mirëqënien e qytetarëve të secilit Rifatit po i pengon, se po thot qytetarët po presin, qytetar jeni edhe ju sikur ne njësoj duhet me u debatu kjo qështje unë kam thënë që ju duhet me i bërë kërkesat e juaja për buxhet dhe financa qfar keni mangësi dhe qfar keni nevoja, sa i përket braktisjes së shkollës ka mekanizma të cilët e rregullojnë këtë çështje, sepse prindërit ndonjëher mundën me qenë të padërgjegjshëm, na mendojm që jemi të ndërgjegjshëm, ndonjëher edhe si prindër mundemi me qen të pandërgjegjshëm ka mekanizma për atë arsye ekzistoni ju si komunitet me çu deri në fund secilin çështje që ka të bëjë me.. nuk është fjala për braktisje të shkollës është fjala për martesat e hershme ka shumë gjana që duhet të mendohen komunitet dhe është koha dhe momenti që duhet me diskutu edhe ju duhet me u ndi edhe me u trajtu barabartë sikurse të gjithë ne dhe na duhet me pas durimin secilin me ju dëgju juve deri në

fund.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Hyrije, Rifatit ju ka përmendur emri ka të drejt për replik drejtor urdhëro.

Rifat Stojkaj

Faleminderit shumë për fjalën kryesues një sqarim të shkurt, për mos me pas keqkuptime, Rifatit nuk i pengon zëri, i askujt as mentaliteti as fjala po e pata ni qasje proaktive që desha me thënë një diçka tjetër. Ne këtu po rrim për shkak se paguhemi me taksat e qytetarëve, por edhe nifarë forme e respektojmë të zgjedhurit të popullit për kohën që jemi këtu, personalisht me thënë 99% të rasteve jam me ju, ju dëgjoj dhe ju pres në secilën seancë nëse ka dikush pyetje ose diçka çka unë mundem me ju shërby atyre, esenca është se na e kem edhe një punë tjetër, e që duhet me ju përgjigjë edhe qytetarëve atje, tu e dit se të gjithë jemi qytetar, më pëlqej diskutimi i zotëris edhe për mu ke e pakuptimtë edhe tash është e pakuptimtë edhe herave të tjera, sepse kam qen edhe unë anëtar i kuvendit komunal ma herët kur je pjesë e një komisioni po besoj që të gjithë anëtarët e komisionit japin mendimet e veta, japin sugjerimet e veta dhe paraqesin një pjesë të një subjekti politik aty në komision. Pastaj gjithë dakordohen edhe kryetari i atij komisioni i paraqet atë rezymen ose përmbledhjen që e ka, për mua është pa kuptim kur e ki një kryetar komisioni jepet fjala pastaj ndërhyrjet dhe jepen mendime, ato mendime është mirë secili anëtar i komisionit me i paraqit në komision ka filtra është komuniteti i politikës dhe financave ku shoshitën gjitha këto nuk më pengon gjuha e askujt, përkundrazi jemi në demokraci vlerësohet mirëkuptohet, ndëgjohet fjala e gjithë secilit mirëpo kaniher duhet me qen pak më vigjilent dhe me ekonomizu kohen sepse na presin edhe punë të tjera ju falemnderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtor kush patë këtu ().

Vatan Istrefaj

Faleminderit kryesues, po ndërlidhem pak me drejtorin, drejtor saktësisht është se ne jemi kuvend komunal dhe këtu jemi me kuvendu pavarësisht asaj tash edhe me ligjin e ri të pagav na po marrim ni pagë dinjitoze këtu kështu që as muajin janar nuk kemi mbajtur seancë po edhe nëse është nevoja jam i gatshëm me qëndru gjithë ditën gjithë natën për këtë punë paguhem edhe jam në shërbim të qytetarëve si ju si ne, por nëse ti ke ndonjë qytetarët që është duke të pritur ose ke ndonjë obligim shtesë mundesh me kërku leje dhe mu largu por derisa qëndron këtu nuk është mir me

Hajdar Sutaj

Unë medova diçka për raport

Vatan Istrefaj

Sa qëndron drejtor ose qendro si duhet

Hajdar Sutaj

Më falë përbesë, A pat dikush për raport, mos të dalim jashta teme Yllarta Thaqi e ka fjalën.

Yllarta Thaqi

Faleminderit sa i përket raportit, ju përgëzoj për raportin e kemi përfaqësuesen tonë Elmedinen që është pjesë e komitetit njëkohësisht edhe Ldk-ja e kan përfaqësuesen janë të zëshme puna e tyre shihet edhe në raport, sa i përket buxhetit të drejtoris ka kohë që është bërë centralizimi përmesë zyres së kryetarit të gjitha kërkesat të cilat i rreferon kësaj zyre shqyrtohen dhe miratohen ndersa sa i perket sa i perket braktisjes së shkollës është fenomen i cili nuk ka ndodhur këto 4 vitet e fundit ka ndodh edhe ma herët edhe komitetet paraprake e kanë diskutu këtë punë janë mundu me gjetë zgjidhje e kan diskutuar me Unmik-n me Osbe janë mbajtur trajnime i

kemi vizituar edhe ma herët edhe këto familje, por nuk kan gjetur zgjidhje. Mbetet në domenin e familjeve, por me ndiku e jo të anëtarëve të komisionit, përdryshe ju përgëzojmë, vazhdoni me punën e juve kërkesat e komunitetit janë të barabarta edhe me kërkesat tona.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Yllarta, kush nuk ka folur, kush nuk ka folur në lidhje me temën atëher Shkëlzen, Fikri po të lutem, Fikri Qufaj e ka fjalën, ju lutem afrojeni mikrofonin zotri Fikri.

Fikri Qufaj

Përsëritet për të gjithë, përsëritet kryesues, përsëritet për 2 drejtorët që janë të pranishëm, unë pata vetëm me falenderu kryesuesin e komuniteteve edhe për punën edhe për raportimin shumë të kuart dhe vetëm i dëshiroi suksese e punë të mbarë e na vjen shumë mirë me raportimin tënd shumë të kuart, ndoshta ne u ankuam pak kështu me pyetje ty të falënderoj shumë për punën dhe të gjithë ata që jeni bashk duke punuar suksese në të ardhmen.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Fikri, e kemi thënë edhe në komitet për politik e financa ne krejt qfar jemi të interesuar, jemi të interesuar që ju mos me pas një trajtim qëllimshëm të keq na kemi mungesa të gjithë po mos me mungu diçka që e kanë shumica me ju mungu pakicës edhe për këtë arsye kemi vullnetin dhe dëshirën me ju përkrah maksimalisht aq sa kemi mundësi si qytetarë të barabartë të këtij shteti faleminderit për raportin edhe për paraqitjen kalojmë tek pika e 7 që është shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të komisionit komunal për emërtimin e rrugëve, lista me emra rezervë të rrugëve të komunës së Deçanit është Orgesi është Ariani është Moni jam unë që jemi anëtar () jemi prezent që jemi anëtar të këtij komisioni nëse ndokush nga kolegët që jeni këtu Orges ose dikush dëshironi me dhënë ndonjë sqarim shtesë sa për informatën e juaj kan qen mbi 300 kërkesa të cilat komisioni për emërtimin e rrugëve i ka shqyrtuar fillimisht në takime këtu pastaj kemi dalë fshat për fshat në terren, bashkë me përfaqësuesit e fshatrave në këtë rast kryetarët e këshillave, në bazë të proces verbalit që e kemi mbajt gjithësecili pastaj i kemi verifikuar edhe njëher në takimet që i kemi pasur këtu dhe pastaj listën të cilën na e kemi miratuar, e kemi dërgu në agjencionin kadastral të Kosovës, me qëllim që mos me votu emra të cilat refuzohen pastaj atje edhe me pas një keqkuptim më thënë e ka votu kuvendi dhe e ka kthyer agjencionin kadastral. Agjencionin kadastral na i ka kthyer shumë propozime të cilën ne e kemi marrë me vrejtje që me u ndrru edhe disa mu largu tërësisht edhe pastaj ne i kemi bërë disa plotësime ndryshime ato të cilat i ka kërku dhe i kemi larguar ato të cilat kanë kërku me i largu kjo listë që e keni këtu është lista e fundit që ata kanë dorëzuar që i plotësojnë kriteret për mu emërtu. Por një sqarim shtesë është që përpara ka qen që njëher në 10 vite me u ndryshu lista me emra rezervë tashë nuk e thotë ligji ashtu, ligji e thotë qdo vit munden me upërditësu nëse ne i kemi 150 emra dhe i emërtojm nga kjo listë 10 rrugë, 10 kemi të drejt vitin tjetër mi shti, dotëthotë ne pranojm kërkesa edhe tash, por 10 kan drejt me u fut ne listen rezerv sapo informimin e juaj deri në vitin 2029 nuk ka zëvendësim të emrave, domethanë mu largu një emër ku është rruga e emërtume edhe me u ngjit një emër tjetër këto që i keni janë të gjitha emra të rrugëve të pa emërtume, po domethanë këtu nuk i keni emrat të cilat kanë me u zëvendësu jo deri në 2029 nuk ka, këtu janë vetëm rrugët të cilat nuk kan qen të emërtuara asnjëher janë rrugë të reja edhe përndryshe komisioni ka me vazhdu me pas punën edhe këtë vit sa e ka mandatin, qfardo që keni diçka për të shtuar urdhëroni fjalën përfundimtare më këtë list nuk kemi nevoj me dërgu, kjo është lista si ta marrim atë vendim komisioni ka drejtë në mbledhjen e parë vetëm me shiku a është i kompletum dokumentacioni i një emri të caktuar, që është biografia, lista e nënshkrimeve etj edhe menjëher futet në sistem. A keni diçka me thanë, Fikri Qufaj e ka fjalën.

Fikri Qufaj

Po kryesus unë kisha dëshir me dit pak a shum arsyen ose emrat të ayre rrugëve në qfarë mënyre janë larguar, për çfarë arsye, pak a shum po e dim.

Hajdar Sutaj

Po e kemi menduar dhe me i thirr kryetarët e këshillave të fshatrave me ju dhënë spjegimet, realisht vetëm

kan rënë në kundërshtim me kriteret ligjore domethanë asnjë kundërshtim për neve ska qen tjetër, ka rënë në kundërshtim me kriteret ligjore nuk ka qen gjatësia nuk ka pasur numër të shtëpive sa parashihet dhe në bazë të kësaj ka ra jo per diqka tjeter perndryshe emrat te cilet pershembull janë kan të gjatë kan rekomanduar me i ndryshu në përputhje me... po edhe paska edhe Moni listën e tërësishme, në konsultim domethanë me propozust e kemi bërë ndryshimin nuk bënë ky emër e kan sjell një propozim tjetër, rrespekt dikush tjetër po Miftar Ahmetxhekaj.

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë kryesues meqenëse ne si parti e kemi pasur përfaqësuesin tonë (Skender) në komision dhe i cili mendoj që e ka perfunduar detyrën dhe punën në mënyrën më të mirë të mundshme dhe ka rekomanduar që kjo list është ajo përfundimtare, unë po kom pas fatin me pa edhe atë rekomandimin e ministrisë së agjensionit për të cilin ka bërë vërejtje të caktume, po kur ka emra me dy kuptimsi, kur ka më shumë se sa dy emra përshembull emri i prindit dhe mbiemri i ka bërë disa vërejtje unë mendoj që duhet ti japët mbështetje kësaj liste faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kështu unë jam kryesues i komisionit ju e keni votuar, Ariani është nga Aak-ja, është Skenderi nga Ldk-ja, është Orgesi nga Vetëvendosja, është Moni nga Pdk-ja, është Shkëlzeni është () është Vjollca, nuk e dinë se harrova dikun, të gjithë e kanë bërë punën një komplimentin të veçantë e kisha dhënë për Shkëlzenin, Shkëlzen Shehi i cili në mënyrën profesionale mënyrën më të mirë të mundshme që e ka bërë ndonjë komun edhe si propozimet që i ka sjell, a ka qen punë e zorshme po ka qen, se ke të bëjë direkt me qytetarin, ka pasur vërejtje ka pasur ankesa ka mundur të ketë ndonjë keqkuptim, është dashur me shku në këmbë nëpër fshatra, po besoj që më në fund po përmbyllet një cikël i mirë i kësaj, nëse ka dikush tjetër diqka, nëse jo e qes në votim,

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatohet që kuvendi komunal mënyrë unanime e ka miratuar listën e propozuar nga komisioni për emërtimin e rrugëve si listë rezervë për këtë vit.

Jemi te të ndryshmet, ju lus të kemi 1 plotësim ndryshim të vendimit për miratimin e planit zhvillimor komunal, e keni të nënvizuar paragrafi 10 pika 2 Neni 10 paragrafi 2 pika 2.1 e nenit në vend se me qen kështu largohet kjo pika 2.1 edhe shtohet, po largohet pika 2.1 dhe shtohet pika 2.1 nën pika 2.2.1 edhe një herë për sqarim, pika 2.1 duhet të largohet mu bë pikat 2.2 edhe me u shtu nën pika 2.2.1 domethanë vetëm kjo është gabim tekstual kur është shkruar vendimi. A keni diqka me thënë, a mundem me qit në votim,

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatohet që kuvendi e ka bërë plotësim ndryshimin e këtij vendimi, jemi te të ndryshmet kush ka diqka tjetër, i kishe 2 pyetje a dëshiron me i dorëzu, me i deponumu që me tu përgjigj në seancen e ardhshme Sylë Balaj urdhëro.

Sylë Balaj

Përshëndetje për të gjithë, Kishim shumë pyetje edhe për drejtor po nuk kemi kujt ti drejtohem na ndodh 3 a 4 herë kështu duhet me qen drejtori këtu, nuk kemi marrë asnjëherë përgjigje.

Hajdar Sutaj

Yllarta Thaqi dëshiron 2 pyetje që pastaj Orgesi që me i lënë për seancen e ardhshme mundësisht lusë sekretaren e kuvendit, që këto kur të nxirren nga traskripta pyetjet të ju përcjellin kryetarit ose drejtorave.

Yllarta Thaqi

Faleminderit shumë po shpresoj se kam marrë përgjigje në seancen e radhes tek drejtorja për kulturë, rini dhe sport e ka një vit qe nuk e kam parë hiq fizikisht drejtoreshen këtu ne seanc, njëkohësisht ne si asamble

komunale marrim vendime edhe për ndarjen e subvencioneve e deri më tani, por tash po jepen si OJQ për organizatat sportive po ndahen me kohë përmes OJQ kemi nda për drejtorinë, për kulturë, rini dhe sport, konkretisht për sportistët e Deçanit 10.000, 20.000, 30.000 me një kushtë që mbrenda vitit kalendarik të shpallet edhe sportisti i vitit.

Kjo nuk ka ndodhë ka vite që nuk ka ndodh që të shpallet sportisti i vitit të mir a po të kqij ata që janë hendboll futboll etj. Njëkohësisht e pash te raporti i kryetarit tek biblioteka e qytetit te dëshmorët e lirisë ku shënon se brenda vitit i ka pasur 102 lexues, mandej edhe fondin që kanë marrë prej librave shqetësuese është 1 njoftim që e kam parë njëkohësisht kam shku edhe me vizitu bibliotekën po ashtu i kam marrur edhe disa njoftime përmes vizitorëve të kësaj biblioteke pse duhet të zhvendoset biblioteka e qytetit në qendrën rinore, ku është e pamundshme që nxënësit e parafillor apo fillor shkoj në qendrën rinore, duke pas parasysh se është 1 largësi jashtëzakonisht e madhe prej qendrës së qytetit për të siguruar 1 libër e duhet të kemi parasysh se në komunat tjera kanë fillu që të bëjnë biblioteka mobile nëpër qendrat e qytetit, njëkohësisht edhe hapin biblioteka ma tepër, ndërsa na e bëjmë të kundërtën, e largojmë bibliotekën e qytetit, e dërgojm në një lokacion tjetër, por mu është shqetësuese kisha dashur që në seancën e radhës këto përgjigje të i kem pikërisht nga drejtoresha për kulturë rini e sport faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit, më fal Orgesi është për fjalë, është Albesa, është Vatani pastaj je ti.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues realisht vetëm për ti deponuar kisha 2 pyetje, 2-jat ose kryetarit ose drejtoreshes së shëndetësis. Pyetja është qfar po ndodh me 2 Amf-t njëra në Mazlik e cila është shëndërruar në shtëpi banimi mbi qfar baze dhe e 2-ta, në Amf në Ratish e cila sipas qytetarëve do të shndërrohet në shtëpi të komuniteti aty dhe krejt ne fund, krejt në fund parkingu në oborrin e komunës ndoshta edhe drejtori Halil mundet me na japë ndonjë sqarim, ne e kemi mbledhjen e kuvendit dhe realisht sa herë që po vijnë kemi problem me parkim a do rregullohet rampa apo do mbetet kështu si është faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges, edhe këto pyetje i përcjellim edhe do të interesohem personalisht që me qen njerzt kompetet që me jepë përgjigje, Vatan.

Vatan Istrefaj

Faleminderit kryesus, e kam një pyetje për ty pasi që është tema për drejtorin, per drejtorin kultur rini dhe sport, drejtorsha gjithëmon ka ardhur në mbledhjet e kuvendit, e shoh që në një periudh një vjeqare ska ardhur asnjëherë më a ka ndonjë arsye shëndetësore apo nuk dëshiron me ardh vetë ndoshta këtu mundesh me u përgjigj ti.

Hajdar Sutaj

Unë nuk jam pjesë e ekzekutivit për këtë temë mundet me u përgjigj kryetari i komunës, krejt qka e di është që drejtoreshë është faleminderit Vatan, Albesa Cacaj e ka fjalën.

Albesa Cacaj

Çështja që du me diskutu e me kërku përgjigje në seancën e ardhshme ka të bëjë me raportin e auditorit, auditimit të pasqyrave financiare.

Në vitin 2023 ka rezultu me 12 rekomandimet, 3 prej tyre janë të reja dhe 9 të përsëritura qëllimi është kështu. Komuna ka pas obligim që me përgatit 1 plan të veprimit, ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen rekomandimet e dhëna mirëpo komuna nuk ka raportuar me kohë lidhur me zbatimin e rekomandimeve përmes raporteve periodike të zbatimit të rekomandimeve, të cilat do duhej të dorëzoheshin me 30.09.2024 dhe me 15 mars të vitit dhe muajt e ardhshëm 2025, kështu që kërkoj që mbledhjen e ardhshme të diskutohet çështja lidhur me progresin e rekomandimeve dhe pyetjet, cilat janë arsyet e vonës ose mosardhjes apo nëse zbatimi është në proces, pavarësisht që nuk ka ardhur në kuvend për raportim, në cilën fazë është? Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit dhe nga ju, Miftar Ahmetxhekaj a ke kërku ose ndoshta më ke thënë për Blineren, në rregull Blinera vazhdo.

Blinera Lokaj

Faleminderit unë kam 1 kritikë drejtuar zyrës për informim, edhe pse nuk është askush i pranishëm këtu, që një kohë të gjatë e kamë vërtetë që shumë procesverbale të kuvendeve komunale janë larguar nga nga faqja zyrtare e komunës, duke përfshirë këtu edhe procesverbalet me debatet publike me qytetarë po ashtu edhe shumica e video incizimeve nuk figurojnë aty ky veprim bie ndesh me transparencën dhe llogaridhënien para qytetarëve po ashtu kjo mund të ndikojë pastaj edhe në treguesit e performancës komunale në sistemin për menaxhimin e performancës komunale. Dje e pashë që e keni publikuar një WebFaqe të re të komunës edhe aty hulumtova, por e pashë se shumica e procesverbaleve dhe videoincizimeve dhe disa nga dokumenteve të rëndësishme të komunës dhe planeve po ashtu mungojnë, kështu që kish me qen mir kërkojm nga zyra për informim që të bëjë përditësimin e rregullt të webfaqes komunale sipas kërkesave ligjore.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Blinera, Arian Dobraj.

Arjan Dobraj

Faleminderit kryesues, meqenëse u përmend diçka edhe tema e drejtorisë së kulturës, rinisë dhe sportit pajtohem edhe me kolegët paraprahe se e trajtuan si temë se me të vërtetë ka kaluar një kohë e gjatë që nga mungesa e drejtoreshës ose mos prezenca e saj në mbledhjet e kuvendit komunal, por në këtë radhe përfshirë edhe mungesën e drejtorëve tjerë pasi edhe kur nuk kemi ndonjëse tema direkte për ta ka disa herë kur na mundemi me u ndërlidhur me tematika ose problematikat dhe drejtorive të tyre, sepse do kishte qenë mirë që të fillojnë të marrin pjesë, ani pse ka 3 vite që nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

